



RADIO
TELEVIZIONI
SHQIPTAR

Kodi i Etikës, Parimet Editoriale dhe Standardet Profesionale të RTSH-së

PËRMBAJTJA

1. STANDARDET EDITORIALE DHE PROFESIONALE

- 1.1 Saktësia
- 1.2 Paanësia
- 1.3 Integriteti editorial
- 1.4 Kontrolli i fakteve
- 1.5 Besueshmëria
- 1.6 Përgjegjësia
- 1.7 Qasja publike ndaj punës
- 1.8 Pavarësia
- 1.9 Ndershmëria në raportim
- 1.10 Gjuha

2. LARMIA DHE BALANCIMI I RAPORTIMIT

- 2.1 Larmia e temave
- 2.2 Larmia e opinioneve
- 2.3 Balancimi i informacionit
- 2.4 Balancimi i informacionit në programe të veçanta
- 2.5 Balancimi i informacionit në programet me seri
- 2.6 Balancimi i informacionit në lajme dhe në programet e aktualitetit
- 2.7 Balancimi i informacionit në dokumentarë

3. FUSHATAT ZGJEDHORE

- 3.1 Pasqyrimi i aktiviteteve të Kuvendit dhe politikanëve
- 3.2 Përballja me partitë politike dhe kandidatët
- 3.3 Paraqitja në programet që nuk kanë lidhje me fushatën zgjedhore
- 3.4 Sondazhet/exit poll-et
- 3.5 Raportimi i rezultateve të zgjedhjeve

4. RAPORTIMI MBI POLITIKËN, POLITIKANËT DHE KUVENDIN

- 4.1 Përdorimi në programe i materialeve nga Kuvendi dhe transmetimet e seancave të Kuvendit të Shqipërisë
- 4.2 Raportimi mbi partitë politike
- 4.3 Terminologjia politike

5. STANDARDET E PRODHIMIT

- 5.1 Mbledhja e informacionit
- 5.2 Sondazhet
- 5.3 Metodatat e sondazheve

- 5.4 Transmetimi i rezultateve të sondazheve
- 5.5 Sondazhet jo shkencore
- 5.6 Votimi telefonik
- 5.7 Telefonatat në studio
- 5.8 Privatësia dhe mbledhja e informacionit
 - 5.8.1 Privatësia kundrejt jetës publike
 - 5.8.2 Identiteti i të dyshuarit/të ndaluarit
 - 5.8.3 Identiteti i të akuzuarit
 - 5.8.4 Identiteti i viktimave të krimit
 - 5.8.5 Mbrojtja e burimeve të informacionit
 - 5.8.6 Anonimati në programe
 - 5.8.7 Refuzimi i paraqitjes në një program
 - 5.8.8 Embargot
- 5.9 Lajmet
- 5.10 Intervistat
- 5.11 Intervistat nëpërmjet telefonit
- 5.12 Komentet
- 5.13 Pagesat
- 5.14 Rastet e veçanta
- 5.15 Pagesa e të ftuarve/pjesëmarrësve në program
- 5.16 Pagesat për deputetët, këshilltarët, ministrat, zyrtarët e qeverisë dhe partive
- 5.17 Raportimi i ngjarjeve të jashtëzakonshme
 - 5.17.a Protestat
 - 5.17.b Trazirat
 - 5.17.c Terrorizmi
 - 5.17.d Kronika e zezë dhe aksidentet
- 5.18 Mjetet profesionale
 - 5.18.a Teksti
 - 5.18.b Figura

6.MARRËDHËNIET ME AUTORITETET SHETËRORE / ORGANET E QEVERISJES

- 6.1 Marrëdhëniet me ushtrinë
- 6.2 Marrëdhëniet me policinë

7. SJELLJET IMITUESE DHE ANTISHOQËRORE

- 7.1 Metodat e fshehta të mbledhjes së lajmeve
- 7.2 Mosprezantimi si gazetar
- 7.3 Kamerat e fshehta dhe mikrofonat
- 7.4 Rrjedhja e informacionit zyrtar/konfidencial

8. GAZETARIA HULUMTUESE

9. PËRPUNIMI I INFORMACIONIT

- 9.1 Drejtuesit e emisioneve dhe intervistuesit
- 9.2 Gazetarët
- 9.3 Komentuesit e ftuar
- 9.4 Redaktimi
- 9.5 Redaktimi i intervistave
- 9.6 Përdorimi i materialit arkivor
- 9.7 Përdorimi editorial i teknologjisë
- 9.8 Kompozimi i pamjeve
- 9.9 Regjistrimi, përzgjedhja e planeve/këndeve të kamerës
- 9.10 Montazhi
- 9.11 Përdorimi i teknologjisë kompjuterike pas prodhimit
- 9.12 Rindërtimi dhe përngjasimi i një ngjarjeje
- 9.13 Materiali arkivor
- 9.13.a Sinjalizimi për përdorimin e materialit arkivor
- 9.13.b Keqpërdorimi i materialit arkivor
- 9.13.c Materiali arkivor që përshkruan një krim
- 9.14 Kombinimi i aktualitetit me dramatizimin
- 9.15 Satira

10. RESPEKTIMI I VLERAVE TË SHIKUESVE DHE DËGJUESVE

- 10.1 Pëlqyeshmëria
- 10.2 Raportimi mbi çështjet e shëndetit
- 10.3 Raportimi i pamjeve erotike
- 10.4 Hidhërimi dhe vuajtja
- 10.5 Dhuna
- 10.6 Njoftime paralajmëruese
- 10.7 Ndërprerjet e programit
- 10.8 Karakteristika të veçanta të radios

11. PROGRAMET ME INTERES TË VEÇANTË

- 11.1 Pakicat etnike
- 11.2 Shqiptarët që jetojnë jashtë
- 11.3 Feja
- 11.4 Shërbimi ndërkombëtar

12. PORTRETIZIMI I GRUPEVE TË VEÇANTA TË SHOQËRISË

- 12.1 Gratë
- 12.2 Personat me aftësi të kufizuara
- 12.3 Pakicat gjinore
- 12.4 Njerëzit e moshuar

13. FËMIJËT DHE TË MITURIT NË PROGRAMET E RTSH-SË

14. NDËRHJRJET

- 14.1 Kërkesat ndaj RTSH-së për të mos transmetuar materiale
- 14.2 Vetoja mbi emisionin nga të ftuarit
- 14.3 Censura

15. E DREJTA PËR KORRIGJIM

16. KUJDESTARI I STANDARDEVE EDITORIALE, PROFESIONALE DHE I PARIMEVE TE ETIKËS GAZETARESKE

17. REFERENCAT E DETYRUESHME

18. NDIHMA LIGJORE PËR GAZETARËT DHE REDAKTORËT

19. REKLAMA, PROMOVIMI DHE SPONSORIZIMI NË PROGRAMET E RTSH-SË

- 19.1 Kriteret etike të reklamave
- 19.2 Reklammat dhe materialet promovuese
- 19.3 Reklammat për fondacionet, shoqatat humanitare dhe thirrjet për bamirësi
- 19.4 Transmetimi i materialit të marrëdhënieve publike
- 19.5 Gazetarët, prezantuesit dhe redaktorët që shfaqen në reklammat dhe programet promovuese
- 19.6 Sponsorizimi në programe

20. PARAQITJA NË TRANSMETIM DHE KODI I VESHJES

21. KONFLIKTI I INTERESIT, TË DREJTAT DHE DETYRAT

- 21.1 Konflikti i interesave financiare dhe të biznesit
- 21.2 Paraqitja dhe pjesëmarrja në mediat audiovizive konkurrenente
- 21.3 Aktivitetet tregtare
- 21.4 Gazetaria financiare
- 21.5 Dhuratat, përfitimet dhe shpërblime të tjera të veçanta
- 21.6 Veprimtaritë politike, sindikaliste dhe profesionale

22. MEDIA ONLINE, MEDIA SOCIALE DHE KONTRIBUTET E AUDIENCËS

- 22.1 Mbledhja e lajmeve nga mediat sociale
- 22.2 Përdorimi i medias sociale për të komunikuar në emër të RTSH-së

23. NDËRVEPRIMI ME AUDIENCËN, ÇMIMET, PROGRAMET ME KUICE, TALENT SHOW etj.

23.1 Parimet

23.2 Votimet

23.3 Materialet e regjistruara dhe ritransmetimet

23.4 Çmimet

23.5 Shërbimi telefonik

23.6 Lojrat dhe kuicet

23.6.a Përzgjedhja e pjesëmarrësve

23.6.b Ndershmëria ndaj pjesëmarrësve

23.6.c Siguria

23.6.d Rregullat

24. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. STANDARDET PROFESIONALE

Standardet editoriale dhe profesionale janë politika të qëndrueshme dhe të vlefshme, që rregullojnë veprimtarinë krijuese në RTSH, në përmbushje të misionit të vet si transmetues publik në shërbim të publikut. Këto standarde janë të nevojshme dhe të vlefshme edhe në rastet e ndryshimeve të pritshme të teknologjisë së transmetimit.

RTSH është gatshme që në të gjithë procesin e vlerësimit, saktësimit dhe të zbatimit të standardeve editoriale dhe profesionale, të gjykojë në mënyrë profesionale përmbajtjen e programeve audio dhe audiovizive dhe të vendosë vetëm mbi bazën e gjykimit profesional.

Standardet editoriale dhe profesionale të RTSH-së mishërojnë integritetin dhe cilësinë që aspiron ky institucion. Gjykimet në lidhje me mënyrën se si zbatohen këto standarde mund të ndryshojnë në varësi të formave apo subjekteve. Është e natyrshme që jo të gjitha krijimtaritë të kenë të njëjtin sukses në përmbushjen e të gjitha këtyre standardeve.

Cilësia e përmbajtjes së programeve duhet të bazohet, në fund të fundit, në profesionalizmin e krijuesit, në pavarësinë, ndershmërinë, integritetin, gjykimin e shëndoshë, sensin e përbashkët, pikëpamjet e hapura dhe qëllimin për të informuar.

Parimet e përgjithshme mbi të cilat bazohen standardet editoriale dhe profesionale, të cilat përbëjnë "kushtetutën editoriale" të RTSH-së, janë:

1.1 Saktësia

Integriteti i programit audioviziv varet shumë nga saktësia e tij.

RTSH është e angazhuar të garantojë se çdo material programor që do t'i përcillet publikut, do të paraqitet saktësisht dhe në kontekstin e tij.

RTSH garanton se të gjitha programet që përmbajnë editoriale, analiza, komente dhe këndvështrime të ndryshme, do të vlerësohen sipas së njëjtave standarde që karakterizojnë raportimin e lajmeve.

Mesazhi i transmetuar duhet të pasqyrojë faktet dhe nuk mund të jetë çorientues apo i pavërtetë.

Gazetari ka për detyrë të mbledhë informacionet me kujdesin e duhur, t'i verifikojë ato dhe t'u kushtojë vëmendje për t'i shprehur në stilin letrar të gjuhës shqipe ose të një gjuhe të minoriteteve.

Gjatë raportimit mbi çështjet aktuale dhe persona realë duhen shmangur teknikat e realitetit virtual, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë i shërben mesazhit dhe mbrojtjes së të drejtave personale.

Informacioni i pavërtetë mund të shkatërrojë besueshmërinë e RTSH-së.

RTSH është një instrument jashtëzakonisht i fuqishëm, ndaj asnjëherë nuk duhet të përdoret si mjet manipulimi për qëllime të caktuara, të ndikojë apo të ndryshojë zhvillimin e ngjarjeve, në raport me audiencën.

Krijuesit/autorët e programeve apo emisioneve nuk duhet të përdorin teknika të tilla që mund ta manipulojnë atë që, në fakt, ndodh në realitet.

Shpejtësia në raportim nuk duhet të marrë përparësi mbi saktësinë.

Gazetarët nuk duhet të publikojnë kurrë hamendjet e tyre; nëse mendojnë se diçka ka ndodhur, duhet ta hulumtojnë plotësisht dhe të kontrollojnë të gjitha faktet përpara transmetimit.

Redaktorët duhet t'i lexojnë të gjitha informacionet për t'u siguruar që ato janë të vërteta.

Gazetarët duhet të kërkojnë të paktën dy burime të pavarur për të konfirmuar çdo fakt.

Duhet të bëhet e qartë nëse informacioni bazohet në një burim të vetëm apo nëse vetë gazetari është burim i dorës së parë (dëshmitar apo ka dëshmuar lidhur me ngjarjen).

Burimet duhet të jenë të bazuara në fakte dhe jo në thashetheme.

Është më mirë që kontakti të jetë i drejtpërdrejtë me burimin, sesa me anë të telefonit apo forma të tjera komunikimi.

Burimet anonime duhen përdorur vetëm në kushte dhe në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm pasi gazetarët të jenë bindur për vërtetësinë, origjinalitetin dhe vlefshmërinë e burimit.

Për të sqaruar situata të ndërlikuara ligjore mund të përdoren burimet politike apo ekonomike, duke i prezantuar qartë dhe me gjuhën e duhur.

Edhe nëse informacioni duket se ka ardhur nga një website i besueshëm, duhet të verifikohet me burimet e informacionit.

Citimet duhen përdorur në kontekstin që janë thënë.

Kur një citim është i përkthyer duhet të verifikohet saktësia e përkthimit.

Të gjitha format e interpretimit duhet të shmangen.

Citimi duhet t'i atribuohet personit që është cituar dhe nuk prezumohet të jetë fakt.

1.2 Paanësia

Paanësia është një vlerë themelore e të gjitha programeve të Radio Televizionit Shqiptar, misioni i të cilit është informimi objektiv i publikut. Mesazhet e transmetuara nuk duhet të jenë çorientuese për publikun.

RTSH nuk do të marrë në konsideratë asnjë program ose material, nëse vihet re se përmbajtja e tyre ka fakte të trajtuara në mënyrë të njëanshme dhe manipuluese, apo fakte të padokumentuara dhe pasaktësi.

Raportimi duhet të jetë i paanshëm, i plotë dhe mirëinformues. Faktet dhe pikëpamjet duhet të përcillen dhe të prezantohen në mënyrë të baraspeshuar. Raportimi duhet të marrë parasysh të gjithë personat, institucionet, çështjet dhe ngjarjet në mënyrë të paanshme dhe etike.

Paanësia në programet e aktualitetit nuk mund të sigurohet nga një bilanc i thjeshtë aritmetik, që peshon qëndrimet me kundërqëndrimet, por me një paraqitje të plotë të rrethanave, që kanë shkaktuar këto (kundër)qëndrime.

Raportimi duhet të shmangë çdo gjë që shkakton dyshime të arsyeshme lidhur me paanësinë e gazetarit ose të transmetuesit të shërbimit publik ose çdo gjë që mund të krijojë idenë se gazetari ose transmetuesi janë të ekspozuar ndaj presionit të një grupi të caktuar, qoftë ai ideologjik, politik, financiar, me natyrë sociale, fetare apo kulturore.

Gjithsesi, kërkesa për paanësi nuk mund të barazohet me neutralitetin e plotë në çdo lajm. Një gazetar mund të shprehë një gjykim profesional, në bazë të fakteve që kanë lidhje me çështjen, por jo një mendim personal, që shpreh pikëpamje të njëanshme për çështjen.

Krijuesit e programeve të radios dhe televizionit (punonjësit dhe të ftuarit) nuk mund të fshehin ose të shpërfillin informacione, me të cilat ata personalisht nuk pajtohen. Për çdo rast, duhet t'i referohen eprorëve.

RTSH ndalon çdo material që, bazuar në gjykimin e këtij institucioni, i trajton njerëzit apo opinionet e tyre qëllimisht në mënyrë të diferencuar, si dhe duhet t'i shmangët çdo gjëje, që do të shkaktonte një dyshim të arsyeshëm lidhur me paanësinë e gazetarit apo të transmetuesit publik. RTSH duhet të shmangë raportimin që do të krijonte idenë se gazetari apo transmetuesi janë nën ndikimin e ndonjë grupi të caktuar, qoftë ai i natyrës ideologjike, politike, financiare, sociale, fetare apo kulturore.

RTSH u garanton personave apo institucioneve të kritikuar të drejtën për t'u kundërpërgjigjur.

1.3 Integriteti editorial

Të gjithë punonjësit e RTSH-së janë përgjegjës për reputacionin e institucionit.

Reputacioni i Radio Televizionit Shqiptar mbështetet fort në besimin e publikut për integritetin editorial të përmbajtjes së programeve audio dhe audiovizive, si dhe në procesin e prodhimit dhe transmetimit. Për të ruajtur këtë besim, RTSH është përgjegjëse për mbrojtjen e veprimtarisë krijuese dhe editoriale nga presioni politik ose ndikimi i papërshtatshëm nga reklamuesit apo burime të tjera. RTSH është e vendosur dhe do të bëjë çdo përpjekje për të siguruar që përmbajtja e programeve audio dhe audiovizive që përcillet në publik, të plotësojë me rigorozitet standardet editoriale të strukturuar për të siguruar integritetin e institucionit.

1.4 Kontrolli i fakteve

Gazetarët dhe redaktorët e RTSH-së duhet të respektojnë rregullin bazë profesional: kontrolli i të gjitha fakteve para se të dalin në transmetim. Nëse nuk është i mundur verifikimi, atëherë duhet të deklarohet burimi nga është marrë informacioni. Nëse burimi është i besueshëm, por nuk dëshiron të bëhet publik, atëherë mund të përdoren disa fraza, të tilla si: "nga burime të besueshme"; "nga burime të verifikuara"; "nga burime të mirëinformuara", "nga burime diplomatike", "nga burime të afërta me...." etj. Programet e

RTSH-së, si rregull, duhet të shmangin përdorimin e frazave të tipit: "thuhet se..."; "flitet se..."; "kemi dëgjuar se..." etj.

Kujdes i veçantë duhet treguar kur përdoren burime të paautorizuara nga interneti. Interneti lejon qasje të pakufizuar dhe përdorimi i të dhënave të paverifikuara mund të çojë në keqinformimin e publikut.

Para se të transmetohen përmbajtje të paautorizuara nga interneti duhet të kontrollohen të gjitha faktet. Nëse përdoret një burim i paautorizuar nga interneti, gjithsesi, ai duhet të jetë i theksuar qartë si i tillë.

Aty ku është e mundur duhet identifikuar burimi i faqes dhe autorësia e materialeve (jo çdo faqe që duket zyrtare mund të jetë e vërtetë).

Redaktorët duhet të kenë të gatshme një listë faqesh të identifikuara si burime të besueshme informacioni.

Burimet gjithmonë duhet të verifikohen, veçanërisht kur kemi të bëjmë me ato që përdoren për herë të parë. Kjo mund të bëhet nëpërmjet bisedave telefonike ose duke takuar njerëzit që janë të përfshirë në marrjen e informacionit. Për verifikimin e burimit nuk duhet të përdoret email ose ndonjë formë tjetër e komunikimit virtual, përveç rasteve kur garantohet verifikimi i identitetit të burimit dhe informacionit që ofrohet.

Kur gazetari merr informacione të ndryshme duhet të gjendet një burim tjetër që ose ta miratojë ose ta hedhë poshtë këtë informacion.

Të gjitha burimet e informacionit duhet të jenë të qarta për publikun, përveç rasteve kur burimi kërkohet të jetë anonim, por gazetari ia njeh vlerën.

1.5 Besueshmëria

Në shoqërinë demokratike, besueshmëria është një nga vlerat themelore të Transmetuesit Publik.

RTSH garanton se asnjë material nuk do të lejohet të përmbajë manipulim të ndërgjegjshëm të fakteve apo përzgjedhje të tyre me qëllim propagandimi. Programet e transmetuara duhet të ofrojnë shpjegimet përkatëse të ngjarjeve dhe çështjeve që t'i mundësojnë publikut të krijojë përshtypjet e veta.

Gazetarët dhe të gjithë krijuesit e tjerë të programeve radio dhe televizive të RTSH-së duhet të jenë të pavarur në punën e tyre. Ata duhet të ruajnë autonominë e profesionit të gazetarisë, si edhe të gjitha profesioneve të tjera, që ndihmojnë në realizimin e programeve të RTSH-së.

Programet e lajmeve duhet të ofrojnë pasqyrim të plotë të ngjarjeve dhe çështjeve, duke lejuar publikuntë formojë pikëpamjet e tij.

Besueshmëria kërkon që të gjithë ata që kontribuojnë në programet e radios dhe të televizionit, ta shmangin solidaritetin publik me çdo lloj veprimi të partive politike apo shoqatave, shoqërive apo grupeve të tjera të interesit, si dhe grupeve të lobimit, solidaritet që mund të interpretohet si mbështetje ndaj njëres prej palëve, grupit të partive ose shoqatave.

Gazetarët e kanë të ndaluar të bëjnë plagjiaturë. Duhet cituar burimet e website, gazetarët e tjerë, apo organe të tjera të medias.

1.6 Përgjegjësia

Qëllimi kryesor i mbledhjes së lajmeve dhe transmetimit të tyre është që të sigurojë një qasje sa më të gjerë të mundshme dhe t'u japë mundësinë përdoruesve për të formuar opinionet e tyre për çështje të caktuara. Gazetarët dhe redaktorët nuk duhet të abuzojnë me pozitën e tyre duke përhapur lajme të rreme apo të manipuluar.

Përgjegjësia përfshin edhe ndjeshmërinë që mund të tregohet apo krijimin e një distance të caktuar nga materialet që shpërndahen nga agjencitë e marrëdhënies me publikun, që synojnë krijimin e imazhit dhe famës për personalitete të caktuara.

RTSH i raporton të gjitha ngjarjet në vend dhe jashtë tij, që janë të rëndësishme për publikun. Të njëjtat standarde dhe parime etike duhet të zbatohen edhe kur raportohen ngjarjet brenda RTSH-së.

1.7 Qasja publike ndaj punës

Puna e gazetarit është publike. Gazetarët e RTSH-së duhet të punojnë në përputhje me këtë rregull. Ata/ato duhet të refuzojnë kategorikisht çdo përpjekje, nga çdo institucion apo individ, për të kufizuar aksesin publik të punës së gazetarit, ose përpjekjet për ta përdorur atë për interesa të caktuara që bien ndesh me parimin e lirisë dhe pavarësisë së profesionit të gazetarit.

Fshehtësia e burimeve, e rekomanduar nga Këshilli i Europës, duhet respektuar, me përjashtim të rasteve kur kjo gjë mund të vërë në rrezik jetën apo sigurinë e individëve (për shembull në rastet e paralajmërimeve për bomba apo zjarr, rrëmbim apo kërcënime të kësaj natyre) ose në rastet kur redaktorët dhe gazetarët duan të fshehin veprimet kriminale të individëve, grupeve apo organizatave.

1.8 Pavarësia

Standardi i pavarësisë respektohet në RTSH dhe shtrihet përtej idesë që lajmi apo informacioni duhet të jenë neutral.

Gazetarët, në asnjë rast, nuk duhet të krijojnë përshtypjet e tyre në bazë të paragjykimit apo të lejojnë vënien në pikëpyetje të integritetit të tyre profesional.

Gazetarët duhet t'i përmbahen, në çdo situatë, parimit të autonomisë dhe të pavarësisë së programeve të RTSH-së, duke u mbështetur në parimet editoriale dhe standardet profesionale, të miratuara nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

Edhe në rastet kur programet e RTSH-së janë bashkëprodhime, apo prodhime të palëve të treta (buxheti i shtetit, sponsorët), RTSH duhet të ruajë pavarësinë e saj editoriale në përgatitjen e këtyre programeve. Edhe këto programe janë subjekt i standardeve profesionale dhe etiketë këtij kodi.

RTSH pranon qasjen që një informacion i caktuar të konsiderohet i pavarur, apo i paanshëm, me kusht që të jetë e qartë se nga vjen informacioni dhe cilat janë të dhënat e përdorura, për të arritur në konkluzione të caktuara.

Raportimi për çështje që kanë kundërthënie është thelbi i mbrojtjes së interesit publik. Për këtë arsye, asnjë strukturë editoriale nuk duhet ta pengojë raportimin e çështjeve të tilla.

1.9 Ndershmëria në raportim

Në raportimet e tyre, gazetarët dhe redaktorët e RTSH-së duhet të respektojnë integritetin e individëve dhe të drejtën e tyre për privatësi. Personave të kritikuar ashpër në programet e RTSH-së, në rastin më të parë të mundshëm, duhet t'u jepet mundësia për t'u përgjigjur. Reagimi duhet të transmetohet në të njëjtin program, në të njëjtën orë. Koha e përgjigjes duhet të jetë e barabartë me kohën e kritikës. Reagimet që tejkalojnë këtë kuadër mund të refuzohen nga redaktori/përgjegjësi i programit.

Asnjë lajm apo program nuk mund të konsiderohet si i drejtë nëse:

- nuk përfshin të gjitha faktet të rëndësishme;
- përfshin fakte të parëndësishme dhe shpërfill ato më të rëndësishmet;
- padashur apo me qëllim mashtron shikuesit dhe dëgjuesit;
- gazetarët përdorin shprehje ose skema që tregojnë anësi të tyre.

RTSH ka standarde të larta profesionale. Është objektiv i këtij institucioni që këto standarde të jenë njëkohësisht standardet e çdo bashkëprodhuesi të lidhur me të. RTSH ndalon transmetimin e çdo lloj programi nëse ka arsye të besohet se një operator mediatik i caktuar ka thyer normat bazë të sjelljes profesionale.

Shembuj të sjelljes joprofesionale konsiderohen:

- përdorimi i materialeve të tjerëve pa respektuar të drejtën e autorit dhe të transmetimit;
- fabrikimi i informacionit ose mbledhja e tij nëpërmjet ryshfetit ose kanosjes;
- mungesa e humanizmit ndaj tragjedit apo zisë njerëzore;
- konflikte interesi të shfaqura nëpërmjet pranimit të ryshfeteve, dhuratave, favoreve, kompensimeve nga ata që mund të jenë të interesuar të ndikojnë në prodhimin e programit.

1.10 Gjuha

RTSH duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë gjuhës shqipe.

Gjuha duhet të jetë e qartë dhe e thjeshtë, duke shmangur teprimet dhe paqartësitë. Drejtuesit e programeve, moderatorët dhe gazetarët (si edhe të gjithë krijuesit e tjerë të programeve, të punësuar dhe të pavarur), janë të detyruar të përdorin stilin letrar shqip dhe gjuhët e minoriteteve.

Gazetarët duhet të përdorin gjuhën standarde gjatë leximit dhe kur moderojnë programe. Përdorimi i dialekteve është i pranueshëm vetëm nga persona të cilët nuk janë të punësuar nga RTSH apo në rastet me interes të veçantë shoqëror (të tilla si ruajtja dhe zhvillimi i dialekteve të caktuara).

Është i rekomandueshëm transmetimi i kontributeve nga autorë nga minoritetet, në gjuhën e tyre amtare, me titra në shqip.

Në parim, programet e RTSH-së nuk lejojnë përdorimin e shprehjeve vulgare apo përdorimin e gjuhës që nuk është në përputhje me normat e pranuar shoqërore. Megjithatë, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se pranimi publik në lidhje me shprehje të caktuara është në ndryshim të vazhdueshëm.

Në rrethana të caktuara bëhen të pranueshme disa shprehje gjuhësore që, në situata të tjera, mund të shkaktojnë ankesa. Megjithatë, këto shprehje duhet të jenë në funksion të mesazhit që përcjell programi. Për më tepër, duhet të jetë e kuptueshme që shmangia e këtyre shprehjeve mund të cenojë cilësinë e programit.

2. LARMIA DHE BALANCIMI I RAPORTIMIT

2.1 Larmia e temave

Programet e RTSH-së duhet të sigurojnë informacion të bollshëm dhe ekuilibër të përshtatshëm mes lajmeve ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.

Programet informative të RTSH-së duhet të sigurojnë ekuilibër të përshtatshëm mes lajmeve nga politika, ekonomia, çështjet sociale, teknologjia, kultura dhe sporti.

Është e rëndësishme që gazetarët dhe krijuesit e RTSH-së të bëjnë kërkime dhe të paraqesin si ngjarje pozitive, ashtu edhe negative, personalitete apo dukuri shoqërore, si edhe ngjarje të rëndësishme të veçantë, edhe pse këto mund të mos jenë ngjarje të bujshme.

2.2 Larmia e opinioneve

Në mënyrë që të arrihet një ekuilibër dhe paanësi, RTSH duhet të sigurojë një larmi sa më të gjerë të mundshme perspektivash dhe opinionesh. Programet e RTSH-së duhet të jenë politikisht neutrale, që do të thotë se gazetarët dhe redaktorët nuk lejohen t'u japin përparësi pozicioneve të caktuara politike apo ideologjike. Paraqitja e opinioneve dhe perspektivave duhet të jetë tërësore.

Programet e RTSH-së duhet të jenë të plotë. Nëse kjo nuk mund të arrihet në një trajtim të vetëm, duhet të sigurohet nga një seri trajtesash, që i kushtohen një çështjeje të caktuar. Nëse një program i vetëm, për arsye të veçanta, nuk është i balancuar, ai duhet të etiketohet qartë si i tillë. Publiku duhet të informohet në lidhje me datën e saktë dhe kohën e transmetimit kur do të përfshihen faktet që mungojnë. Lajmet dhe programet e aktualitetit duhet të balancohen brenda një jave, programet javore brenda dy javësh dhe programet mujore brenda një muaji.

Gazetarët dhe redaktorët duhet të shmangin gjuhën e urrejtjes. Kur është e nevojshme, gazetarët parafrzojnë të intervistuarit, me qëllim shmangien e fyerjeve apo fjalëve që nxisin urrejtje.

Kur raportohen probleme sociale, gazetari duhet t'i shërbejë të gjithë audiencës dhe shoqërisë dhe duhet të dëgjojë të gjitha palët. Gazetari duhet të përpiqet të mos paraqesë një këndvështrim të vetëm apo vetëm një aspekt specifik të çështjes.

Gazetarët duhet të pyesin njerëzit që intervistojnë se si dëshirojnë të identifikohen dhe t'u referohen në këtë mënyrë gjatë raportimit të ngjarjes.

Gazetarët duhet të përfshijnë zërat e pakicave, gratë, minoritetet kombëtare dhe fetare si burime për të gjitha çështjet dhe jo vetëm për çështje që kanë të bëjnë me ta. Ata duhet t'u japin zë të gjithë anëtarëve të komunitetit dhe jo vetëm liderëve të tyre.

Pasqyrim i diversitetit do të thotë ofrim i hapësirës grupeve të ndryshme sociale, që të mund të shprehin pikëpamjet e tyre. Gazetari duhet t'u japë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

-Kush mungon në këtë ngjarje që po raportoj?

-Cila është audienca?

-Cili është konteksti i ngjarjes?

-Ku mund të marr më shumë informacion?

-Kur është e përshtatshme të përdor identifikim racor apo etnik?

-Pse e përfshij/përfshijtoj këtë informacion?

-Si mund ta përfaqësoj sa më mirë diversitetin e shoqërisë, veçanërisht grupet më të pafavorizuara?

2.3 Balancimi i informacionit

Programet e RTSH-së që merren me çështje të interesit publik, duke krijuar opinion publik, duhet t'i trajtojnë qëndrimet e ndryshme në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, gjë që në këtë kontekst nënkupton paanësinë dhe marrjen parasysh të peshës së qëndrimeve dhe mendimeve të caktuara, si edhe rëndësinë potenciale të tyre.

Nëse është e mundur, gazetari duhet të gjejë përfaqësues të të gjitha palëve dhe pozicioneve relevante të përfshira dhe t'i paraqesë në lajm apo program. Nëse kjo rezulton e pamundur, ai duhet ta informojë publikun lidhur me këtë, në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë.

RTSH, në bazë të parimit të balancës, në çdo kohë, mund të refuzojë pranimin e një materiali, derisa prodhuesi i atij materiali të marrë përsipër fshirjen e sekuencave nga materiali ose shtimin e këndvështrime të tjera.

Materiali i shtuar mund të variojë nga disa fjalë, në episode të tëra të reja e deri në programe të reja.

Për materialet *online*, faqet e besueshme mund të përdoren si një mundësi për të pasur informacione shtesë ose këndvështrime të ndryshme.

2.4 Balancimi i informacionit në programe të veçanta

Një program që trajton një çështje madhore të diskutueshme, duhet t'i ofrojë opinionit publik informacionet e duhura. Ndershmëria duhet të jetë parimi kryesor në paraqitjen e çështjes, në mënyrë që publiku të jetë në gjendje të gjejë mbi çështjen në fjalë në bazë të fakteve.

2.5 Balancimi i informacionit në programet me seri

Edhe pse një seri brenda një programi mund të pasqyrojë një pikëpamje të veçantë, programi në vetvete duhet të ofrojë një spektër të gjerë për pikëpamjet e ndryshme mbi temën që trajtohet. Synimi i paraqitjes së një pikëpamjeje përgjithësisht të balancuar duhet të jetë i qartë paraprakisht për shikuesit dhe dëgjuesit.

2.6 Balancimi i informacionit në lajme dhe në programet e aktualitetit

Lajmet dhe programet mbi aktualitetin duhet të paraqesin një pikëpamje të përgjithshme të ekuilibruar të çështjeve të debatueshme, për të shmangur promovimin e opinioneve të veçanta ose manipulimin e ngjarjeve. Gazetarët dhe redaktorët duhet të jenë të vetëdijshëm për nevojën për balancim në paraqitjen e çështjeve të debatueshme.

2.7 Balancimi i informacionit në dokumentarë

Kur dokumentari portretizon në mënyrë të debatueshme, njerëz realë ose situata aktuale, ai duhet të jetë i saktë dhe i bazuar në fakte.

Çdo rindërtim i një ngjarjeje aktuale të debatueshme duhet të jetë i drejtë. Është e pashmangshme që realizimi krijues i disa elementeve, të tilla si karakterizimi, dialogu dhe atmosfera, do të ketë një dimension imagjinar, por kjo nuk duhet të çojë në shtrembërimin e fakteve reale.

Kur është e nevojshme, personat e portretizuar apo të afërmit e tyre duhet të njoftohen paraprakisht dhe, kur është e mundur, duhet të sigurohet bashkëpunimi i tyre. Nëse bashkëpunimi ose miratimi prej tyre nuk realizohet mbi baza të arsyeshme, sërish dokumentari duhet të realizohet.

3. FUSHATAT ZGJEDHORE

3.1 Pasqyrimi i aktivitetit të Kuvendit dhe politikanëve

Gjatë fushatës zgjedhore, RTSH do të vërë në dispozicion minutazh falas për KQZ, për partitë politike të regjistruara dhe kandidatët e pavarur që garojnë në zgjedhje. Hapësira kohore falas e vënë në dispozicion do të jetë në kushte të barabarta për të gjithë dhe e ndarë sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Rendi i paraqitjes përcaktohet përmes shortit. Shorti është publik.

Nuk lejohet përdorimi i materialit arkivor të RTSH-së për promovimin e partive politike.

Partitë që duan të shfrytëzojnë minutazhin falas duhet ta konfirmojnë këtë me shkrim brenda afatit të përcaktuar nga RTSH.

RTSH, në përputhje me kërkesat e saj programore dhe kapacitetet teknike, do të informojë me shkrim partitë politike dhe kandidatët në lidhje me orarin e regjistrimeve në radio dhe televizion.

Mungesa gjatë një regjistrimi të planifikuar bën që partitë/kandidatët të humbasin të drejtën për transmetim pa pagesë.

3.2 Përballja me partitë politike dhe kandidatët

Programet e posaçme për partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore duhet t'u qëndrojnë besnike këtyre parimeve:

- a) Debati duhet të ndërmjetësohet dhe të drejtohet nga gazetarë që moderojnë bisedën/debatin mes përfaqësuesve të partive politike apo kandidatëve në mënyrë të paanshme dhe pa paragjykime.
- b) Gazetarët që drejtojnë/moderojnë debatin e emisioneve zgjedhore janë të detyruar t'u japin pjesëmarrësve mundësinë e prezantimit të pikëpamjeve/opinioneve të tyre brenda kohës së caktuar. Pjesëmarrësit që nuk e respektojnë kohën e përcaktuar duhet të ndërpriten. Drejtuesit e emisioneve dhe gazetarët duhet të kenë të paktën njohuri minimale mbi dispozitat e Kodit Zgjedhor.
- c) Hapësira kohore për secilën forcë politike do të bëhet në bazë të ligjit apo rregullores në fuqi.
- d) Prania e forcave politike në intervale të caktuara kohore në programe të veçanta propozohet nga RTSH; radha e paraqitjes përcaktohet përmes shortit.
- e) Emisionet gjatë fushatave zgjedhore, si rregull, janë programe të drejtpërdrejta. Subjektet politike, që nuk e shfrytëzojnë kohën e caktuar për t'u paraqitur në program, nuk kanë të drejtë për paraqitje tjetër.
- f) Për programet e drejtpërdrejta në studio, me pjesëmarrje publiku, çdo partie i jepet një numër i njëjtë vendesh.

3.3 Paraqitja në programet që nuk kanë lidhje me fushatën zgjedhore

Gjatë fushatës zgjedhore, përfaqësuesve të partive politike ose kandidatëve që garojnë nuk u lejohej të paraqiten në emisione të tjera të RTSH-së, me përjashtim të rasteve të përmendura në pikën 3.1. Kur pasqyrohen aktivitetet e përfaqësuesve të partive politike dhe kandidatëve që mbajnë poste qeveritare apo publike, RTSH duhet të bëjë dallimin e qartë midis funksioneve të tyre zyrtare dhe veprimtarisë zgjedhore.

3.4 Sondazhet/exit poll-et

Exit poll-et bazohen në intervistimet e njerëzve që sapo kanë votuar. Qëllimi i tyre nuk është që të parashikojnë se çfarë do të bëjnë njerëzit, por se çfarë kanë bërë tashmë. Redaktorët kanë për detyrë të vlerësojnë me kujdes transmetimin e këtyre sondazheve. RTSH-ja mund të autorizojë kryerjen e sondazheve me pjesëmarrësit në votim vetëm nëse vlerëson se kompanitë kanë besueshmëri dhe kanë dëshmuar profesionalizmin e tyre në zgjedhjet e mëparshme.

Në emisionet mbi rezultatet e zgjedhjeve, dhënia e rezultateve paraprake mund të bazohet qoftë duke u mbështetur në të dhënat e sondazheve, qoftë në rezultate reale të deklaruara nga KQZ-ja, por duhet të jetë e qartë për publikun se këto nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën. *Exit poll*-et mund të realizohen gjithashtu për të analizuar situatat kur votuesit kanë votuar kundër pritshmërisë së përgjithshme. Pesë ditë para ditës së votimit ndalohej publikimi i sondazheve.

3.5 Raportimi i rezultateve të zgjedhjeve

Raportimi i rezultateve të votimit që nuk ka si burim Komisionin Qendror Zgjedhor kërkon kujdes të veçantë.

Në raste të tilla, punonjësit e RTSH-së duhet të zbatojnë disa rregulla:

- Lajmi i parë në emisionin e lajmeve apo në programin e posaçëm nuk duhet të mbështetet vetëm në rezultatet e një sondazhi të bazuar në një apo disa qendra votimi (*exit poll*-et); nuk duhet të bazohet tek interpretimi i rezultateve të sondazhit që bëhet nga një organizatë që e ka autorizuar kryerjen e tij.

- Konstatimet e *exit poll*-eve duhen raportuar në kontekstin e prirjes së përgjithshme. Kjo e fundit mund të konstatohet bazuar në rezultatet e të gjitha sondazheve brenda një periudhe të caktuar ose mund të kufizohet vetëm në gjetjet e një sondazhi. Rezultatet e sondazhit, të pashoqëruara me shpjegim bindës, duhen trajtuar me dyshim dhe kujdes.

- Nuk duhet të përdoret një gjuhë që u jep sondazheve besueshmëri më të madhe sesa meritojnë: sondazhet sugjerojnë, por asnjëherë nuk dëshmojnë, tregojnë apo provojnë.

Duhet të raportohen të dhëna të sakta që merren në terren dhe duhet të vihen në pah ngjarjet që mund të kenë pasur ndikim të rëndësishëm në opinionin publik në kohën që është realizuar sondazhi.

Rezultati i zgjedhjeve dhe rezultati i votimit janë dy gjëra të ndryshme. Media ka të drejtë të jetë e pranishme në fazën e votimit. Lajmi për pjesëmarrjen në votime reflektohet në procesverbalin e qendrës së votimit. Rezultati i votimit çertifikohet mbas numërimit të votave në KZAZ (Komisioni Zgjedhor i Administrimit Zonal).

Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, sipas ligjit, i shpall Komisioni Qendror i Zgjedhjeve!

4. RAPORTIMI MBI POLITIKËN, POLITIKANËT DHE KUVENDIN

4.1 Përdorimi në programe të materialeve nga Kuvendi dhe transmetimet e seancave të Kuvendit të Shqipërisë

Materiali parlamentar mund të përdoret për lajmet, programet e aktualitetit, për qëllime arsimore, për emisione zbavitëse, ose programe të tjera të RTSH-së.

Deklaratat e bëra në kuvend gëzojnë një privilegj të caktuar me rastin e raportimit dhe kjo i jep RTSH-së mbrojtje nga akuzat për shpifje.

Raportimet nga kuvendi, që transmetohen në RTSH duhet të përcjellin në mënyrë të paanshme zhvillimet në seancë, që do të thotë se ato duhet të paraqesin të gjithë spektrin e opinionëve për një çështje në mënyrë të balancuar.

Gazetari duhet të informojë publikun me lajmin e tij, me argumentet pro dhe kundër të deputetëve për çështjet që debatohen. Edhe pas mbylljes së debatit në kuvend mund të ketë hapësirë për debat për çështje të caktuara, ndaj RTSH paraqet këndvështrime të ndryshme, deri në momentin që gjykon se janë paraqitur të gjitha opinionet rreth çështjes së debatuar.

Redaktimi i fjalimeve në kuvend duhet të paraqitet me qartësi, çka do të thotë që nëse një material është i redaktuar, ai nuk duhet të paraqitet sikur është i poredaktuar.

Punonjësit e RTSH-së kanë detyrimin që të mos japin qëndrime personale gjatë transmetimeve drejtpërdrejt të seancave të parlamentit.

4.2 Raportimi mbi partitë politike

RTSH raporton mbi veprimtarinë e partive politike. Misioni i RTSH-së, si transmetues i shërbimit publik, është që të mbajë një qëndrim të balancuar ndaj të gjitha partive.

Prania e një partie politike në transmetimet e RTSH-së varet nga veprimtaria e partisë. Konferencat për shtyp nuk duhet të jenë i vetmi matës i veprimtarisë së tyre. Prandaj, RTSH nuk është e detyruar që, përveç fushatave zgjedhore, t'u ofrojë paraprakisht partive kohë të barabartë transmetimi. Megjithatë, redaktorët duhet të kenë parasysh që t'u japin hapësirën e duhur të gjitha pikëpamjeve të partive kryesore rreth një çështjeje të debatueshme. RTSH vendos se cili zyrtar partiak merr pjesë në programet e saj. RTSH është e detyruar të sigurojë që paneli me të ftuar të jetë sa më përfaqësues dhe i balancuar. Kur një pjesëmarrësi i bëhet ftesë, por refuzon ose nuk është në gjendje të dalë në transmetim, kjo normalisht nuk është arsye për anulimin e transmetimit. Në një rast të tillë, RTSH do të përpiqet të sigurojë një zëvendësim të përshtatshëm, në mënyrë që të sigurohet që në program të paraqiten pikëpamje të ndryshme. Megjithatë, mund të ketë raste kur refuzimi apo mungesa e të ftuarit të bëjë që programi të jetë i njëanshëm dhe i pabalancuar. Në këto raste mund të konsiderohet shtyrja ose anulimi i programit. Këto raste shqyrtohen me kujdes dhe merret vendimi përkatës.

Redaktorët dhe gazetarët, para se të intervistojnë liderët e partive, duhet të konsultohen paraprakisht me kryeredaktorët, me përjashtim të prononcimeve të shkurtra për emisionin e lajmeve.

Në rastin e transmetimit të bisedimeve tepër të gjata me kryeministrin për çështje aktuale, ne duhet të ofrojmë mundësi të ngjashme për transmetim nga partitë në opozitë. Reagimi duhet të transmetohet në një segment ekuivalent të programit, nëse është e mundur, menjëherë pas shfaqjes së kryeministrit ose në edicionin e ardhshëm në të njëjtën seri të programit dhe jo më vonë se dita në vijim.

RTSH nuk është e detyruar të transmetojë materiale të gatshme nga partitë politike apo zyrat e shtypit të institucioneve shtetërore. Në ato raste kur gjykohet të përdoren pjesë të materialit të ofruar, kjo duhet të bëhet e qartë me titra në ekran ose/dhe nga gazetari/folësi.

4.3 Terminologjia politike

Gjuha e përdoruar në raportimet politike është shumë e rëndësishme. Ne duhet të jemi të vetëdijsëm se fjalë/fraza të veçanta kanë nuanca të caktuara. Për shembull, përdorimi i fjalës "pretendim" kërkon kujdes të veçantë. Ekziston rreziku që në lajme të përdoret fjala "pretendim" në vend të "thotë se" vetëm për të mos krijuar përsëritje. Nëse themi që njëra palë "thotë" dhe pala tjetër "pretendon", kjo nënkupton se priremi të besojmë njërin palë dhe jo tjetrin. Në mënyrë të ngjashme duhet treguar kujdes në përdorimin e fjalëve të thjeshtëzuara apo shkurttimeve.

5. STANDARDET E PRODHIMIT

5.1 Mbledhja e informacionit

Raportimi duhet të bazohet në kërkime të thella të gazetarit/es dhe jo në thashetheme.

5.2 Sondazhet

Edhe gabimi më i vogël gjatë referimit të fakteve mund të dëmtojë besueshmërinë e një programi të tërë. E njëjta gjë vlen për sondazhet. Prandaj sondazhet dhe rezultatet e tyre duhet të paraqiten në përputhje me standardet profesionale të saktësisë, paanësisë dhe besueshmërisë së informacionit. Sondazhet dhe studimet/anketimet e opinionit nuk kryhen nga gazetarët dhe departamentet editoriale të RTSH-së, por autorizohen të kryhen nga institucione dhe ekspertë që, në punën e tyre, bazohen në metoda dhe standarde profesionale. Të gjitha sondazhet/studimet duhet të autorizohen paraprakisht nga kryeredaktori.

Duhet të kihet parasysh se organizata apo ekspertë ndonjëherë shprehin interesa të partive apo grupeve të ndryshme, ndaj është i nevojshëm balancimi i sondazheve. Rekomandohet që sondazhet për çështje të debatueshme sociale, për ngjarje të rëndësishme, si zgjedhjet, të bëhen të paktën nga dy organizata/ekspertë të pavarur.

5.3 Metodatat e sondazheve

Anketat dhe "kampionet e rastësishme" janë dy teknika të zakonshme që përdoren për sondimin e opinionit publik.

Anketimi përdoret për të zbuluar fakte, për të nxjerrë në shesh qëndrime dhe për të verifikuar hipoteza.

Të dhënat e mbledhura paraqesin bazën për studime të ndryshme dhe raporte që publikohen nga qeveria, lobistët, grupet e interesit, hulumtuesit dhe shoqatat e gazetarëve.

Për të siguruar vlefshmërinë e këtyre rezultateve, anketimi i opinionit publik duhet të bëhet sipas metodave të testuara dhe standardeve të mirënjohura. Çdo devijim nga këto teknika dhe standarde duhet bërë i njohur për publikun.

5.4 Transmetimi i rezultateve të sondazheve

Para transmetimit të rezultateve të ndonjë sondazhi, gazetarët pritet që:

- të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për metodat e përdorura, si dhe rezultatet kryesore të sondazhit;
- të krahasojnë interpretimin e rezultateve nga autorët e studimit me opinionet e ekspertëve të tjerë në këtë fushë;
- të flasin për metodat e përdorura dhe interpretimin e rezultateve.

Në transmetimin e rezultateve të sondazheve, gazetarët duhet:

- t'u japin përparësi rezultateve/të dhënave dhe jo interpretimit të tyre;
- të raportojnë emrin e personit ose organizatës që bën sondazhin dhe, ku është e nevojshme, lidhjet/anësitë me parti politike, emrin e sponsorit, popullsinë e anketuar, madhësinë e kampionit të përdorur, periudhën gjatë së cilës është kryer anketa, përqindjen e pjesëmarrësve/refuzuesve të përgjigjeve dhe kufirin e gabimit.

Të dhënat e detajuara publikohen në faqet e internetit dhe rrjetet sociale të RTSH-së.

5.5 Sondazhet joshkencore

Sondazhet që nuk janë kryer sipas standardeve të njohura nuk ofrojnë rezultate të vlefshme apo informacion të besueshëm.

Duhet treguar kujdes i posaçëm në paraqitjen e deklaratave (në emisione të drejtpërdrejta apo të regjistruara) të marra përmes intervistave të rastësishme me persona në kuvende apo audiencia telefonike.

Komentet e marra në këtë mënyrë duhet të paraqiten për të vetmin qëllim që të ilustrojnë larminë e opinioneve për çështjen në diskutim. Duhet të kihet kujdes që të mos sugjerohet që komente/opinione/deklarata të tilla, pasqyrojnë opinionin e komunitetit për çështjen në fjalë. Në mënyrë të ngjashme, ndërsa komenteve në këto raste mund t'u bëhet një përmbledhje, në asnjë rrethanë nuk duhet të pasqyrohet numri i tyre pro/kundër.

5.6 Votimi telefonik

Votat telefonike - telefonuesit ftohen të telefonojnë në numra të caktuar dhe çdo telefonatë numërohet mekanikisht si votë - janë lehtësisht të manipulueshme nga çdo grup i interesuar. Ato nuk kanë vlerë lajmi dhe mund të jenë çorientuese.

Lajmet dhe programet e aktualitetit të RTSH-së nuk realizojnë dhe as bëjnë lajm për votat telefonike. Përbërës bëjnë disa programe argëtuese, ku votimi telefonik për veprimtari

ndërkombëtare bëhet sipas metodologjive të pranuar dhe ku mungesa e besueshmërisë së tij balancohet me metodat e tjera të votimit dhe vlerësimit të garuesve ose pjesëmarrësve.

5.7 Telefonatat në studio

Telefonatat në RTSH, si rregull, bëhen në emisione të drejtpërdrejta. Kjo do të thotë se producenti/redaktori duhet të jetë vazhdimisht vigjilent për mundësinë që telefonuesi mund të thyejë ligjin, të fyejë, të lëndojë apo të shprehet me gjuhë të pakëndshme.

Për të minimizuar rrezikun, redaktorët dhe autorët e programit duhet të sigurohen që drejtuesit e programit të jenë të informuar siç duhet, të jenë në gjendje të dalin, shpejt dhe me mirësjellje, nga një situatë e vështirë. Si rregull, kjo bëhet duke ndërprerë lidhjen me telefonuesin, ndërkohë që drejtuesi/drejtuesja vijon bisedën me çështje apo të ftuar/telefonues të tjerë. Kur redaktori/redaktorja i/e programit parandien se mund të ketë probleme me këto telefonata të drejtpërdrejta, ai/ajo, ose persona të ngarkuar, flasin paraprakisht me telefonuesit dhe u shpjegojnë rregullat e programit, duke i paralajmëruar për përgjegjësitë e mundshme në raste të shkeljeve të rënda të etikës.

Telefonuesit në programe të tilla, veçanërisht në programet që merren me çështjet politike, duhet të prezantohen me emër dhe mbiemër. Një prezantim me emër dhe mbiemër nuk kërkohet domosdoshmërisht në të ashtuquajturat programe këshillimi (programet e shëndetit, programet bujqësore etj.).

5.8 PRIVATËSIA DHE MBLEDHJA E INFORMACIONIT

5.8.1 Privatësia kundrejt jetës publike

Privatësia e një individi në emisionet e RTSH-së nënkupton jetën personale dhe private të individit, të veçuar nga jeta e tij publike.

Ka raste kur gazetarët cenojnë jetën private të individit. Një gjë e tillë përlligjet vetëm atëherë kur jeta private e individit:

- ndikon në jetën e tij/saj publike;
- bëhet pjesë e jetës së tij/saj publike;
- bëhet çështje legjitime e shqetësimit të publikut.

Në situata të caktuara, individi nuk duhet të identifikohet. Me identifikim, në këtë rast, nënkuptohet më shumë sesa thjesht raportim emri; nënkuptohet mospërdorim fotosh, apo edhe raportim i ndonjë detaji të rastësishëm, që çon në zbulimin e identitetit të individit.

Edhe kur çështjet personale të figurave publike bëhen temë, ato nuk humbin të gjitha të drejtat për privatësi. Gazetarët e RTSH-së duhet t'u përmbahen vetëm fakteve të rëndësishme dhe të shmangin thashethemet. Informacioni i transmetuar, përveçse i rëndësishëm, para së gjithash duhet të jetë i vërtetë. Është thelbësore që ne të respektojmë të

drejtën e personave për privatësi, t'i trajtojmë ata me ndershmëri, pa hequr dorë nga hulumtimi i çështjeve që kanë rëndësi për publikun.

Gazetari hulumtues, si rregull, punon në mënyrë të fshehtë, por një reporter që raporton lajme të përgjithshme, gjatë kërkimit të informacionit, duhet ta paraqesë veten si gazetar. Njerëzit reagojnë ndryshe kur e dinë se përballë kanë një gazetar.

Gazetarët e RTSH-së duhet të marrin miratimin e njerëzve që kanë intervistuar; miratimi mund të jetë edhe në formën e lejes së regjistruar.

Miratimi është një marrëveshje e qartë, vullnetare dhe informuese se për çfarë do të përdoret materiali nga media. Kjo marrëveshje duhet të merret në mirëbesim nga gazetari.

Gazetari duhet të bëjë të qartë se miratimi i dhënë nënkupton që përmbajtja mund të shfaqet në çdo pajisje që disponon transmetuesi.

Situatat kur njerëzit janë filmuar në një turmë, shihen si një ilustrim i jetës së përgjithshme publike, ndaj leja nuk është e nevojshme.

Gazetari duhet të informojë njerëzit për synimin e tij, si dhe për kontekstin në të cilin do të përdoret materiali/informacioni i marrë. Gjithashtu, gazetari duhet të bëjë të qartë se materiali mund ose nuk mund të përdoret në një kontekst të ndryshëm.

Gazetari nuk duhet t'i ofrojë kontribuesit lejen për të rishikuar dhe redaktuar materialin që është duke u përdorur. Kur kërkohet miratimi duhet të bëhet e qartë se kontribuesi nuk do të ketë rol editorial apo redaktues.

Gazetari dhe autori i programit duhet të kontrollojnë nëse të gjitha informacionet personale të transmetuara kanë miratimin e personit të përfshirë. Ndonjëherë ky rregull ka përjashtimet e veta. Për shembull, disa njerëz mund të preferojnë të mbajnë të fshehta detaje personale, si për shembull mosha e tyre, si dhe faktin që mund të kenë një histori jo fort të këndshme nga e kaluara. Bërja publike e këtyre fakteve duhet të vihet në "peshoren" e interesit publik.

Privatësia gjykohet mbi bazën e parimit "rast pas rasti". Për çdo situatë, gazetari duhet të marrë parasysh nëse ka një interes publik për dhunimin e jetës private.

Gazetari duhet të mbrojë jetën personale, integritetin, dinjitetin dhe ndjenjat e individit, ndaj ekspozimit të pajustificuar.

Të gjithë ata që mbajnë poste publike ose janë në qendër të vëmendjes publike duhet të jenë të hapur për një shqyrtim publik, të drejtë dhe të paanshëm. Jeta e tyre personale duhet mbrojtur, përveçse në rastet kur ka një interes të publikut.

Fëmijëve, viktimave të krimit dhe aksidenteve, personave me aftësi të kufizuara dhe atyre që janë të paafte për të mbrojtur veten ose për të kontribuar në debat në lidhje me pozicionin e tyre, duhet t'u ofrohet mbrojtje përkundrejt shkeljes së privatësisë së tyre.

Informacionet që kanë të bëjnë me orientimin seksual, gjendjen shëndetësore, të shkuarën apo identifikimin etnik, nuk duhet të publikohen, përveçse kur gazetari ka miratimin ose nëse ka një interes të qartë publik.

Gazetari ka për detyrë të mbrojë identitetin e një burimi anonim.

5.8.2 Identiteti i të dyshuarit/të ndaluarit

Në rastet kur informacioni nga policia ose organet e tjera hetimore zbulon identitetin e të dyshuarit (p.sh. inicialet e tij), për publikimin e tij kërkohet miratimi paraprak nga kryeredaktori.

5.8.3 Identiteti i të akuzuarit

Në raportimet për personat e akuzuar duhet të merret në konsideratë parimi i prezumimit të pafajësisë. Gazetarët duhet të jenë të ndjeshëm për dëmin që mund t'i shkaktojnë një personi të pafajshëm. Në rastet kur i akuzuari është identifikuar në raportimet fillestare, atij i duhet dhënë rëndësia e duhur gjatë raportimit të vendimit gjyqësor. Në programet e RTSH-së, i akuzuari në gjykatë nuk do të paraqitet në rrethana/situata poshtëruese.

Në raportimet e tyre, gazetarët duhet të kenë parasysh nenin 30 të Kushtetutës: "Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë." dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të drejtat e njeriut (e drejta për gjykim të drejtë, të drejtat e të akuzuarit/ndaluarit dhe prezumimi pafajësisë).

5.8.4 Identiteti i viktimave të krimit

Publikimi i identitetit të viktimave shpesh vetëm shton pikëllimin, ankthin e personit dhe traumën.

Si rregull i përgjithshëm, RTSHnuk transmeton identitetin e viktimës së krimit, veçanërisht në rastin e krimeve kundër personit apo sulmeve seksuale, përveçse në një nga rrethanat e mëposhtme:

- viktima jep pëlqimin për identifikim (me shkrim ose të regjistruar);
- viktima tregon vullnetarisht historinë e vet;
- Interesi publik qëndron mbi çdo konsideratë tjetër.

Kur dikush akuzon dikë për krim kundër personit të tij, jashtë një procesi të rregullt ligjor, RTSH nuk i garanton anonimatin viktimës së supozuar. Në këto raste, transmetimi i akuzave bëhet vetëm pas një rishikimi tërësor të provave dhe besueshmërisë së personit, nga gazetarët dhe departamenti ligjor, për të shmangur akuzat për shpifje.

RTSH nuk transmeton në asnjë rrethanë, përveç humbjes së jetës, identitetin e të miturit, i cili është viktimë e krimit.

5.8.5 Mbrojtja e burimeve të informacionit

RTSH mbështet fuqimisht parimin e mbrojtjes së burimeve të gazetarit. Informacioni që publiku duhet të dijë ndonjëherë mund të sigurohet vetëm përmes një burimi të fshehtë. Shpesh figurat publike, por jo vetëm ata, flasin me gazetarët me kushtin që mos të citohen për çfarë thonë. Nëse nuk respektohet parimi i anonimatis të burimeve të informacionit, vihet në pikëpyetje qarkullimi i lirë i informacionit, thelbësor për zhvillimin e një shoqërie demokratike.

Informacioni nga një burim që nuk dëshiron të identifikohet publikisht mund të përdoret nëse burimi është i njohur dhe i besueshëm për gazetarët. Megjithatë, për të shmangur mundësinë e manipulimit, në transmetimin e një informacioni të pasaktë ose të njëanshëm, gazetari duhet të kontrollojë me kujdes besueshmërinë e burimit dhe ta verifikojë atë nga të paktën dy burime të tjera.

Zbulimi i burimit brenda hierarkisë së redaksisë nuk duhet të ngatërrohet me bërjen publike të burimit. Redaktori përgjegjës duhet ta trajtojë një informacion të tillë me fshehtësi absolute. Kur redaktori gjykon se raportit i mungon një element/detaj, që vë në dyshim besueshmërinë dhe saktësinë, ka të drejtë ta refuzojë transmetimin e një materiali të tillë.

Mbrojtja e burimeve është një e drejtë etike që buron nga profesioni, që, ashtu si profesioni i mjekut apo avokatit, gëzon detyra dhe të drejta të veçanta.

Mbrojtja e burimeve nuk është një e drejtë ligjore dhe, sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me sigurinë publike ose situata kriminale, gjykatat dhe organet e tjera gjyqësore të autorizuar mund t'i kërkojnë një personi të zbulojë burimin e informacionit. Në raste të tilla, RTSH duhet ta këshillojë një punonjës që të mos refuzojë dhe t'i bindet një vendimi gjykate. Juristët e institucionit duhet të jenë të gatshëm që ta ndihmojnë gazetarin, madje mund t'i kërkojnë gjykatës, që para se të urdhërojë gazetarin që të tregojë burimin e informacionit, të marrë në konsideratë interesin publik. Nëse gjykata kërkon që burimi i informacionit të bëhet publik, duhet kërkuar që seanca gjyqësore të zhvillohet në prani të kamerave.

5.8.6 Anonimati në programe

Saktësia dhe integriteti në gazetari kërkojnë që identiteti dhe kredencialet e një të intervistuarit të jenë të qarta për publikun.

Nëse një të intervistuarit apo pjesëmarrësi anonim në program i fshihet fytyra, identiteti apo i tjetërsohet zëri, publiku me të drejtë vë në dyshim besueshmërinë e këtij personi, për më tepër fshehja rrit shanset që ky person të bëjë deklaratatë të papërgjegjshme.

Ka raste kur vlera e informacionit që ofrohet nga një i intervistuar anonim, merr përparësi ndaj kundërshtimeve lidhur me mënyrën se si merret dhe transmetohet ky informacion.

Anonimati është i justifikuar kur identifikimi i rrezikon jetën të intervistuarit apo pjesëmarrësit në program.

Rastet kur garantohet anonimati kërkojnë miratimin paraprak të kryeredaktorit të informacionit/programit.

5.8.7 Refuzimi i paraqitjes në një program

Çdokush ka të drejtë të refuzojë të paraqitet në një program. Arsyet e mungesës mund të bëhen publike kur, në mënyrë të arsyeshme, kjo kërkohet prej publikut.

5.8.8 Embargot

Redaktorët dhe gazetarët duhet të respektojnë embargot për materiale të caktuara. Ndonjëherë mund të jetë e mundur bindja e burimit të informacionit për të hequr dorë ose për të afruar kohën e heqjes së embargos.

RTSH udhëhiqet nga parimi i respektimit të embargos edhe kur mediat e tjera nuk e respektojnë atë.

RTSH do të vendosë rast pas rasti për respektimin ose jo të embargos, edhe nëse embargo thyhet nga mediat e tjera.

5.9 Lajmet

Lajmi është kategoria bazë e gazetarisë. Lajmi duhet të jetë i qartë, i pakontestueshëm, i saktë dhe i vërtetueshëm. Lajmi nuk duhet të përfshijë elemente të komentit. RTSH është e përmbytur në transmetimin e të ashtuquajturit lajm - koment/lajm-analizë, i cili mund të jetë i njëanshëm ose çorientues. Kur nuk është e mundur të kontrollohen të gjitha faktet, burimet e lajmeve duhet të theksohen qartë (ATSH, AP, AFP, Reuters etj.).

5.10 Intervistat

Intervistuesi duhet të informojë të intervistuarin para intervistës në lidhje me qëllimin për të cilin do të përdoret intervista/biseda. Gjithashtu, të intervistuarit duhet t'i thuhet me përafërsi se sa e gjatë do të jetë intervista/prononcimi që do të transmetohet, ose t'i bëhet e qartë mundësia e transmetimit të pjesshëm apo që mund të mos transmetohet fare. Në përdorimin e një interviste, RTSH duhet të respektojë kushtet me të cilat është rënë dakord para intervistës.

Kur dy ose më shumë njerëz janë intervistuar individualisht për të njëjtin program ose seri programesh, asnjë pjesëmarrësi nuk mund t'i tregohet ose t'i lejohet të dëgjojë komentet e tjetrit.

I intervistuari duhet të informohet për përmbajtjen e intervistës.

Çdokush që shpreh pikëpamje të diskutueshme gjatë një interviste duhet të testohet rigorozisht. Njerëzit në pushtet, të lidhur me të, njerëz që kërkojnë pushtet ose ata që mbrojnë ose kritikojnë politika të caktuara, duhet të trajtohen me një ton më sfidues. Intervistat e RTSH-së nuk duhet të mbështesin një qëndrim/pozicion/politikë të caktuar, nëse është i diskutueshëm. Intervistat duhet të jenë profesionale, në kërkim të përgjigjeve dhe qartësimi të dilemave. Gazetarët duhet të shmangin përshtypjet dhe paragjykimet përmes tonit të zërit, lakimeve ose formulimeve të pakujdesshme. Nëse një i intervistuar refuzon të japë intervistë pa shikuar paraprakisht pyetjet, redaktori përgjegjës duhet të vendosë për vazhdimin ose jo të programit. Nëse vendoset që të vijojë, duhen bërë të qarta, gjatë transmetimit, kushtet në të cilat është realizuar intervista.

Jo të gjitha intervistat duhet të jetë sfiduese. Disa intervista janë të ideuara për të informuar, shpjeguar apo argëtuar. Në varësi të natyrës së intervistës përdoren teknika të ndryshme. Njerëzit e intervistuar si dëshmitarë okularë apo si ekspertë mund të kenë më tepër nevojë të inkurajohen sesa të sfidohen. Në rastin e intervistave të palëve në një debat, redaktorët janë

të detyruar t'i japin edhe palës tjetër mundësinë e përgënjeshtimit në edicionin e ardhshëm të programit. Kur intervista regjistrohet për t'u redaktuar më vonë, të intervistuarit i duhet thënë kjo gjë. Një i intervistuar, të cilit i është kërkuar që të përgjigjet ndaj kritikave, duhet t'i jepet mundësia që të përgjigjet për secilën nga kritikrat e bëra ndaj tij. Është e padrejtë zgjedhja vetëm e përgjigjeve më të dobëta si kundërpërgjigje ndaj kritikës. Nuk duhen paraqitur si të drejtpërdrejta intervistat që janë regjistruar më parë.

5.11 Intervistat nëpërmjet telefonit

Personi që merret në telefon duhet të jetë i informuar për qëllimin e intervistës dhe t'i merret leje para transmetimit të saj.

Kur intervistat nëpërmjet telefonit bëhen për ballafaqim midis palëve, i intervistuari i parë duhet të jetë i informuar për praninë e të dytit, para se të fillojë intervista dhe, nëse është e nevojshme, i ofrohet mundësia e një replike të shkurtër.

Kur tema është një çështje e debatit publik, balanca është e detyrueshme.

5.12 Komentet

Misioni i RTSH-së kërkon që publiku të informohet sa më gjerësisht të jetë e mundur, në mënyrë të balancuar dhe të paanshme, për ngjarjet me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Edhe pse gazetarët mund të kenë opinionet e tyre për çështjet që raportojnë, në asnjë rast ata nuk duhet të përdorin vetëm ato fakte që i përshtaten mendimit të tyre personal. Nëse transmetohet opinioni personal i një gazetari, kjo duhet të jetë e qartë për audiencën. Meqë opinioni personal mund të bazohet, shumë shpesh, në fakte të pjesshme, redaktorët duhet të sigurojnë që komentet të jenë sa më pluraliste të jetë e mundur. Komentet duhet të jenë balancuara gjatë një periudhe të caktuar kohore, duke përfshirë të gjitha këndvështrimet mbi një çështje. Asnjë gazetar apo redaktor i punësuar në RTSH nuk duhet të mbajë monopolin në lidhje me komentet. E njëjta gjë vlen edhe për komentuesit e pavarur.

5.13 Pagesat

Si rregull i përgjithshëm, RTSH nuk i paguan burimet e lajmeve.

5.14 Rastet e veçanta

Në raste të veçanta, kur duhet bërë pagesa për një burim informacioni, duhet miratimi i kryeredaktorit. Fakti që është paguar për marrjen e këtij informacioni duhet bërë publik gjatë raportimit.

5.15 Pagesa e të ftuarve/pjesëmarrësve në program

Nga ana tjetër, ekziston një kërkesë që, në rrethana të caktuara, të paguhen persona, të cilëve u kërkohet të marrin pjesë në programet e informacionit. Përcaktimi i pagesave të tilla do të bëhet sipas tarifave të përcaktuara dhe të miratuara nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

5.16 Pagesat për deputetët, këshilltarët, ministrat, zyrtarët e qeverisë dhe partive

RTSH nuk bën asnjë pagesë, të çfarëdo lloji, për asnjë qëllim, për zyrtarët e sipërpërmendur.

5.17 Raportimi i ngjarjeve të jashtëzakonshme

5.17.a Protestat

Protestat, demonstratat dhe e drejta për t'i zhvilluar ato, shfaqen në forma të shumta, duke përfshirë marshimet, grumbullimet, procesionet, parakalimet, zaptimin e ndërtesave apo vendeve të tjera, qëndrimin ulur në ambiente publike, bllokime linjash transporti, greva urie dhe nisma të ngjashme, nga individë apo grupe njerëzish.

Shumë ngjarje publike ideohen, planifikohen dhe realizohen duke pasur në mendje pasqyrimin që do t'i bëjë media. Kjo vlen edhe për protestat dhe demonstratat. Ushtrimi i të drejtave dhe lirive nga protestuesit nuk duhet të çojë, nëpërmjet veprimit dhe pasqyrimin të tyre prej RTSH-së, në humbjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Potenciali për manipulimin e pasqyrimin është i madh. Gazetarët e RTSH-së janë të detyruar të respektojnë udhëzimet e mëposhtme:

Vendimi për të pasqyruar një protestë nuk duhet t'i komunikohet askujt jashtë RTSH-së. Garantimi/premtimi për pasqyrim mund të ndikojë në pjesëmarrjen dhe planet e organizatorëve.

Gazetarët duhet të mbajnë distancë nga organizatorët dhe protestuesit.

Ekipet e raportimit duhet të jenë të kujdesshëm ndaj personave ose grupeve, të cilët, në mënyrë të qartë, kryejnë veprime për efekt të kamerave apo mikrofonave.

Ekipet e raportimit nuk duhet të pranojnë sugjerime apo kërkesa të protestuesve, të cilat mund të çojnë në përshkallëzim të ngjarjeve.

Gazetarët duhet të hulumtojnë dhe të raportojnë mbi identitetin e organizatorëve, qëllimin e protestës dhe numrin e pjesëmarrësve.

Nëse një ngjarje publike e planifikuar ndërpritet nga një protestë, ngjarja në vetvete gjithsesi duhet të marrë pasqyrimin që meriton.

Vendimi për të raportuar duhet të bazohet në rëndësinë e ngjarjes, protestës apo demonstratës dhe jo në tingujt dhe imazhet e ofruara.

5.17.b Trazirat

Prania e kamerave dhe mikrofonave në momente trazirash provokon dhunën.

Gjatë xhirimit me qëllim pasqyrimin e ngjarjeve ku priten trazira, duhet të merren masa paraprake për t'u siguruar që prania e gazetarëve, kamerave apo mikrofonave të RTSH-së

nuk do të shkaktojë provokim. Nëse është e qartë që prania e tyre frymëzon një situatë potencialisht të rrezikshme, ata duhet ta ndërpresin përdorimin e pajisjeve regjistruese, madje, në disa raste, edhe duhet t'i fshehin ato.

5.17.c Terrorizmi

Gazetarët e RTSH-së duhet të sigurohen që veprimet që ata ndërmarrin nuk rrezikojnë më tej jetën e pengjeve ose nuk pengojnë përpjekjet e autoriteteve për të siguruar lirin e tyre. Gjatë raportimit të akteve terroriste, gazetarët dhe kameramanët e RTSH-së duhet t'u binden udhëzimeve të mëposhtme:

Çdo komunikim i drejtpërdrejtë nga terroristët/pengmarrësit, që përmban informacione në lidhje me atë që po ndodh apo mund të ndodhë, duhet të raportohet menjëherë te drejtuesi i departamentit të informacionit.

Asnjë deklaratë apo intervistë, e drejtpërdrejtë apo e regjistruar, me një nga terroristët, pengjet apo pengmarrësit, nuk mund të transmetohet pa autorizimin e drejtorit të lajmeve. Një autorizim i tillë jepet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

Deklaratat ose kërkesat e terroristëve/pengmarrësve janë pjesë përbërëse e ngjarjes. Megjithatë, në shumicën e rasteve, ato duhet të transmetohen në mënyrë të përmbledhur ose në formë të redaktuar për të shmangur rrezikun e manipulimit.

Kontaktet me pengmarrësit nuk lejohen. Drejtuesi i Lajmeve mund të autorizojë një kontakt të tillë në raste shumë të veçanta.

Telefonatat ose kontaktet e tjera të drejtpërdrejta me pengjet, terroristët apo pengmarrësit, duhet të ndërmerren vetëm nëse, në gjykimin e drejtorit të lajmeve, një gjë e tillë nuk pengon në komunikimet e autoriteteve ose nuk rrezikon më tej sigurinë e pengjeve.

Gazetarët dhe producentët duhet t'i përcjellin menjëherë kryeredaktorit/drejtorit të lajmeve çdo kërkesë të bërë nga autoritetet, për të shtyrë transmetimin e informacioneve të caktuara në lidhje me krizën apo hetimet që po zhvillohen.

5.17.d Kronika e zezë dhe aksidentet

Gjatë raportimit të lajmeve të kronikës së zezë dhe aksidenteve duhet shmangur buja. Televizioni dhe radio mund të rrisin ndjenjën e frikës që ekziston te njerëzit se vetë ata mund të bëhen viktimat të krimit. Gazetarët duhet të shmangin krijimin e panikut, por njëkohësisht duhet të raportojnë në mënyrë të balancuar ngjarjen, duke i bërë njerëzit të vetëdijsëm për rrezikun që vjen nga krimet e dhunshme. Gjatë raportimit të lajmeve të kronikës së zezë duhet pasur parasysh se e drejta për informim nuk duhet të marrë përparësi mbi të drejtën e individëve për privatësi.

5.18 Mjetet profesionale

5.18.a Teksti

Teksti duhet të fokusohet në fakte. Edhe këtu vlen parimi se çdokush është i pafajshëm deri në momentin e shpalljes së fajësisë nga gjykata. Gjatë raportimit të veprave penale mund të flitet për të dyshuar, jo për kriminelë. Nëse nuk ka informacion nga burime zyrtare duhet bërë i qartë burimi/burimet nga është/janë marrë informacioni/informacionet.

Për shembull, nuk mund të thuhet "ka zëra se...", "flitet/thuhet se...", por duhet cituar burimi: "fqinjët e viktimës thonë"; "kolegët e tij janë të bindur"; "shumica e banorëve pretendojnë"; "dëshmitarët janë të bindur se ..." etj.

Gazetari mundësisht duhet të mbështetet në informacionet e autoriteteve, policisë dhe ekspertëve.

Nëse gazetari konstaton paqartësi, kundërthënie, mashtrim, pasivitet ose shmangie të hetimit dhe ka informacion të bollshëm për të vërtetuar dyshimet e tij, ai duhet të informojë kryeredaktorin.

Burimet zyrtare, si rregull, publikojnë vetëm inicialet e të dyshuarve. Nëse në ngjarje janë të përfshira figura publike (në politikë, sport, spektakle etj.), mund të publikohet emri i plotë i tyre, por vetëm pas miratimit paraprak nga redaktori përgjegjës. Gjithmonë duhet cituar saktë burimi i informacionit.

5.19.b Figura

Gjatë xhiritimit dhe redaktimit të skenave nga lajmet e kronikës së zezë duhet pasur parasysh se nuk është në përputhje me standardet profesionale dhe etike:

-shfaqja e viktimave të krimit në gjendje të pashpresë, aksidenteve, skenave të gjakut, pamjeve nga afër të fytyrës, trupit etj. Skena të tilla duhen xhiruar nga një distancë ku nuk dallohen detaje që mund të zbulojnë identitetin e viktimës. Një këshillë që mund ta bëjë më të lehtë zgjedhjen e skenave gjatë redaktimit: operatori dhe redaktori duhet të përpiqen ta vendosin veten në gjendjen emocionale të të afërmeve, të cilët mësojnë për aksidentin përmes televizionit.

-shfaqja e targave, adresës së shtëpisë dhe detajeve të tjera, në një mënyrë apo tjetër mund të zbulojnë identitetin e viktimës; edhe këtu vlen i njëjti parim: operatori dhe redaktori duhet të zgjedhin pamje që nuk lejojnë identifikimin e viktimës.

6. MARRËDHËNIET ME AUTORITETET SHTETËRORE/ORGANET E QEVERISJES

I krijuar si person juridik publik me Ligjin Nr. 97, datë 04.03.2013, RTSH vepron si një transmetues i pavarur publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive për publikun e territorit të Republikës së Shqipërisë. Drejtuesit dhe punonjësit e RTSH-së bashkëpunojnë me qeverinë/organet zyrtare, në nivel të barabartë dhe nuk marrin apo ekzekutojnë urdhra/udhëzime prej tyre.

Programet e RTSH-së ofrojnë raportim tërësor dhe të detajuar në lidhje me punën e qeverisë dhe organeve të tjera zyrtare, si dhe raportim me saktësi dhe në detaje të këndvështrimeve të opozitës dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Redaktorët dhe gazetarët duhet të mbajnë distancë profesionale nga të gjitha instrumentet e pushtetit, përndryshe mund të rrezikojnë integritetin e institucionit për të cilin punojnë. Ruajtja e sekreteve është detyrë e zyrtarëve dhe institucioneve. Një material me sigël, që shpjegon se përmbajtja e dokumentit është sekrete, në rrethana të caktuara mund të shërbejë si një mbulesë për interesat e jashtëligjshme të individëve, grupeve ose shërbimeve, të cilët duan t'i fshehin publikut fakte të rëndësishme apo procedura të paligjshme. Publikimi i një dokumenti, që mund të rrezikojë sigurinë shtetërore, vendoset nga kryeredaktori në marrëveshje me eprorin e tij.

6.1 Marrëdhëniet me ushtrinë

Në mbulimin e çështjeve ushtarake, drejtuesit e RTSH-së respektojnë parimin demokratik se ushtria është subjekt i autoritetit civil.

6.2 Marrëdhëniet me policinë

RTSH ndihmon publikun duke transmetuar mesazhe të policisë apo njoftime për probleme të trafikut apo të emergjencave. Programet e lajmeve, veçanërisht në nivel rajonal dhe lokal, transmetojnë njoftimet e policisë për informacione në lidhje me krimet e rënda.

Programet e RTSH-së raportojnë për policinë, ashtu si edhe për organet e tjera shtetërore. Programet e informacionit/lajmet duhet të shqyrtojnë rolin e policisë në mënyrë të paanshme dhe pa pasion.

Në disa raste, policia lejon që grupet e gazetarëve t'i shoqërojnë në aksionet e veta. Redaktorët dhe gazetarët duhet të marrin në konsideratë *pro*-të dhe *kundra*-t kur pranojnë këto ftesa. Publiku ka interes të shohë veprimet/aksionet e policisë, por një gjë e tillë ka edhe rreziqet e veta. Ftesa mund të synojë vetëm reklamë; qasja e gazetarëve në aksion mund të jetë e kufizuar dhe raportimi mund të krijojë idenë se edhe vetë gazetarët janë duke marrë pjesë në aksion.

Policia mund të tentojë të sigurojë qasje në materialin e patransmetuar rreth një çështjeje në hetim. Redaktorët dhe gazetarët duhet të marrin në konsideratë problemet që mund të ngrejë dhënia e lejes për të bërë një gjë të tillë.

7. SJELLJET IMITUESE DHE ANTISHOQËRORE

Audienca është e shqetësuar për mundësinë që njerëzit në jetën reale të imitojnë sjelljen që u përcillet nëpërmjet radios dhe televizionit. Ne duhet të përpiqemi të sigurohemi që sjelljet antishoqërore apo kriminale, të portretizuara në programe, nuk mund të kopjohen. Gjithashtu duhet pasur kujdes i veçantë kur flitet për teknikat e përshkrimit të ngjarjeve të kronikës së zezë.

Raportimet për vrasje dhe vetëvrasje duhet të shmangin përshkrimet e detajuara. Programet duhet të shmangin theksin/nënvizimet ndaj disa metodave të kryerjes së vrasjes. Kujdes i

veçantë duhet treguar në realizimin e dokumentarëve/reportazheve që mund të duket sikur madhështojnë aktin e vetëvrasjes ose vrasjes.

Pirja e duhanit dhe alkoolit në programet e fëmijëve, në përgjithësi, duhet shmangur. Nga ana tjetër, në disa programe të veçanta ka raste kur pirja e duhanit është thelbësore për një personazh apo histori. Në programet e përgjithshme, të tilla si debatet në studio, pirja e duhanit është e ndaluar. Pjesëmarrësit në programet e përgjithshme të RTSH-së nuk pinë duhan në transmetim. Pirja e alkoolit nuk duhet lavdëruar.

7.1 Metodatat e fshehta të mbledhjes së lajmeve

Metodat e fshehta të mbledhjes së lajmeve nuk lejohen. Këto metoda mund të përdoren vetëm pasi janë ezauruar përpjekjet për të marrë informacionin. Këto metoda duhen përdorur vetëm duke pasur parasysh raportin me ligjin, me çështjet e privatësisë, me sensin e ndershmërisë profesionale.

7.2 Mosprezantimi si gazetar

Informacioni nuk duhet të merret duke mashtruar/gënjer. Punonjësit e RTSH-së nuk duhet të fshehin apo të gënjejnë rreth identitetit tyre apo synimeve që kanë për të marrë informacion.

Megjithatë, gazetari mund të kërkojë informacion si qytetar i zakonshëm në ato raste kur ka një interes legjitim për ta bërë këtë. Raste të këtij lloji mund të ndodhin, për shembull, gjatë hetimeve të skemave që synojnë mashtrimin e publikut. Këto hetime zakonisht kryhen në vende ku ka qasje edhe publiku i zakonshëm.

Nëse konsiderohet e rëndësishme dhe në interes të publikut, për të kërkuar informacion në vendet ku publiku nuk ka qasje, por pa u prezantuar si gazetar, duhet të merret miratimi i redaktorit përgjegjës.

7.3 Kamerat e fshehta dhe mikrofonat

Si rregull i përgjithshëm, kamerat e fshehta dhe mikrofonat nuk duhet të përdoren për të mbledhur informacion.

Megjithatë, mund të ketë raste kur përdorimi i pajisjeve të fshehura regjistruese mund të konsiderohet në interes të publikut. Raste të këtij lloji, për shembull, mund të përfshijnë një lajm mbi shitjen e hashashit/drogës në rrugë.

Edhe kur është i justifikuar, regjistrimi fshehtas rrezikon të dëmtojë besimin e publikut ndaj RTSH-së. Rrjedhimisht duhet të merret një autorizim paraprak nga redaktori/shefi i programit. Autorizimi mund të jepet vetëm nëse informacioni që do të merret i shërben një qëllimi të rëndësishëm, është i domosdoshëm dhe nuk mund të merret në rrugë të tjera. Kujdes i veçantë duhet treguar në rastin e krimeve të rënda.

Programet argëtuese mund të përfshijnë kamerat e fshehta, por me kushtin që njerëzit e regjistruar të japin leje për transmetimin e materialit.

Në përdorimin e kamerave të fshehta gazetarët duhet të kenë kujdes për privatësinë dhe dinjitetin e njeriut. Nuk lejohet montazh, ndërhyrje që deformon kuptimin e materialit.

7.4 Rrjedhja e informacionit zyrtar/konfidencial

Rrjedhja e informacionit nga institucionet qeveritare është një formë e veçantë e informimit anonim, që përdoret kur zyrtarë të caktuar dëshirojnë të informojnë publikun për tema konfidenciale. Një informacion i tillë mund të jetë i dobishëm, por mbart me vete mundësinë për të qenë i rremë, pasi, jo gjithmonë zbulimi i të vërtetës është qëllimi kryesor i informatorëve/sinjalizuesve. Prandaj, publikimi i një informacioni të tillë është gjithmonë një sfidë etike dhe profesionale për redaktorët dhe gazetarët. Informacione nga burime të tilla duhet të kontrollohen me kujdes në lidhje me qëllimet dhe besueshmërinë e tyre. Sidoqoftë, këto informacione mund të jenë pjesë e rëndësishme e raportimit.

8. GAZETARIA HULUMTUESE

Gazetaria hulumtuese kërkon mjeshtëri dhe ruajtjen e standardeve të saktësisë. Gazetaria hulumtuese nuk duhet të ushtrohet pa burime të mjaftueshme dhe kohën e nevojshme për të kryer një hulumtim shteres.

Audienca mund të nxjerrë përfundime për subjektet që shqyrtohen në programet hulumtuese. Këto përfundime duhet të jenë logjike, që rrjedhin nga faktet dhe jo nga qëndrimet editoriale apo metodat e pandershme/manipuluese të paraqitjes së çështjes. Është thelbësore, pra, që në përputhje me parimet e saktësisë, integritetit, ndershmërisë dhe gjithëpërfshirjes, programet të bazohen në hulumtimin e ndërgjegjshëm dhe të përpiktë. Autorët e programeve duhet të marrin parasysh të gjitha provat e duhura që kanë në shqyrtim dhe të përfshijnë një sërë opinionesh për çështjen në fjalë.

Mundësia për të reaguar është thelbësore për programin hulumtues. Në interes të ndershmërisë duhet t'u jepet mundësia për të reaguar të gjitha palëve të interesuara. Për të shmangur mundësinë e të qenit i manipuluar nga dhënia e informacionit të pasaktë apo të anshëm, gazetari duhet të kontrollojë me kujdes besueshmërinë e një burimi dhe duhet të marrë prova konfirmuese nga burime të tjera të lidhura me çështjen.

Hulumtimi mund të shtrihet edhe në fushën e drejtësisë, madje edhe për vendime të formës së prerë. Në vende demokratike ka ndodhur që gazetarë hulumtues kanë ndikuar për riçeljen e gjykimeve. Por këtu duhet treguar kujdes i veçantë për të mos ndërhyrë në veprimtarinë e gjyqësorit, për të mos cënuar pavarësinë ligjore dhe për të mos bërë veprime fyese, diskriminuese e denigruese.

9. PËRPUNIMI I INFORMACIONIT

9.1 Drejtuesit e emisioneve dhe intervistuesit

Drejtuesit dhe intervistuesit duhet t'i trajtojnë të ftuarit e tyre në mënyrë të drejtë. Ata nuk duhet të jenë kërkues apo kritikë me disa dhe pajtues e dashamirës me të tjerët. Është thelbësore për ruajtjen e besueshmërisë së tyre që ata të mos bëhen avokatë të askujt, jo vetëm në deklaratat publike, por edhe në mënyrën se si debatojnë apo bëjnë pyetjet.

9.2 Gazetarët

Roli i gazetarit është të përcjellë lajmin për publikun, me ndershmëri, saktësi dhe integritet. Për hir të një raportimi të plotë, gazetarët mund të duan të ofrojnë kontekst për ngjarjen që përbën lajm. Për ta bërë këtë, ata mund të paraqesin një shpjegim të sfondit të ngjarjes në bazë të hulumtimit të kujdesshëm. Megjithatë, ata nuk duhet të paragjykojnë apo të shprehin apo të pasqyrojnë mendimin e tyre personal.

Objektivi i dhënies së kontekstit dhe analizës është të sigurojë që publikut, i cili gazetarinë radiotelevizive e ka burim kryesor të informimit, t'i jepet një shpjegim sa më i qartë i lajmit, personaliteteve dhe çështjeve.

9.3 Komentuesit e ftuar

Komentuesi i ftuar, sipas përkufizimit, është i angazhuar për të komentuar mbi çështjet publike. Për shkak të karakterit si një institucion në pronësi publike, RTSH nuk i adapton si të sajat opinionet e komentuesve, të cilët i fton për të artikuluar nuancat e ndryshme rreth një teme/subjekti të caktuar. Qëllimi i RTSH-së është që të sigurojë paraqitjen e një spektri të gjerë të opinionit, veçanërisht kur çështja është e diskutueshme dhe me interes publik. Prandaj RTSH kërkon të zgjedhë komentues, përvoja e të cilëve i kualifikon ata për të dhënë opinionet si ekspertë, që bazohen në informacione të sakta.

Çdo përkufizim i komentuesit/analistit/opinionistit duhet të përmblihet në mënyrë të qartë, në mënyrë të tillë që publiku të vlerësojë lehtësisht pikëpamjen e folësit. Për shembull, pozita dhe përkatësia/simpatia e një gazetari apo kualifikimet e veçanta të një akademiku ose të ndonjë lloj tjetër komentuesi duhet të bëhen të qarta. Përshkrimet "analist", "opinionist" apo "publicist " nuk e përmbushin këtë kërkesë.

9.4 Redaktimi

Procesi i redaktimit duhet të reflektojë atë që është parë dhe dëgjuar në realitet.

Pavarësisht nga kufizimet kohore për "produktin" radioteleviziv, montazhi duhet të jetë konciz dhe i qartë.

Çfarë rezulton nga përzgjedhja dhe montimi është një përmbledhje e realitetit, që duhet të pasqyrojë të vërtetën thelbësore pa shtrembërime.

9.5 Redaktimi i intervistave

Pyetjet dhe përgjigjet nuk duhet të redaktohen në mënyrë të tillë që tëndryshonjë apo shtrembërojë kuptimin e intervistës së realizuar.

Përgjigjet e dhëna për pyetjet e bëra në një kontekst nuk duhet të redaktohen sipas një konteksti tjetër.

Përgjigjja e një pyetjeje nuk duhet të vendoset në një program në mënyrë të tillë që të synojë të jetë përgjigje pa lidhje me pyetjen e bërë.

Në rastet kur ka përsëritje dhe heqja e një pjese duhet bërë patjetër, duhet treguar kujdes që të mbetet thelbi i përgjigjes fillestare.

Dëgjuesit dhe shikuesit nuk duhet të manipulohen, dhe t'u jepet ideja sikur ka debat mes palëve, kur në të vërtetë nuk ka pasur debat.

Për arsye profesionale, në intervistat e regjistruara nuk duhen shtuar, ndryshuar, shtrembëruar apo sajuar pyetje të reja.

9.6 Përdorimi i materialit arkivor

Publiku duhet të informohet kur materialet audiovizive janë regjistruar më parë, veçanërisht nëse, ndërkohë, kanë ndryshuar pikëpamjet e folësit apo ka informacione të reja lidhur me çështjen.

Ritransmetimi i një interviste apo i pjese të një interviste, duhet të trajtohet në mënyrë të tillë që të mos shtrembërohet konteksti origjinal.

9.7 Përdorimi editorial i teknologjisë

Efektet speciale, duke përfshirë efektet e zërit, duhet të përdoren me kujdes të veçantë në paraqitjen e materialit gazetaresk. Në raste të rralla përdorimi, duhet gjykim rigoroz për t'u siguruar që ato nuk shtrembërojnë realitetin.

Saktësia dhe integriteti mund të rrezikohen nga abuzimi me teknologjinë, e cila sot ofron një shumëllojshmëri të gjerë efektesh vizuale, për të modifikuar materialin që është duke u transmetuar. RTSH duhet të shmangë përdorimin e efekteve speciale çorientuese, të mundësuar nga teknologjia e sotme, e aftë për të krijuar realitete virtuale.

Në rastet kur përdorimi i efekteve speciale është thelbësor ose i shkon për shtat qëllimit të programit, përdorimi i tyre i duhet bërë i ditur audiencës.

9.8 Kompozimi i pamjeve

Një tipar themelor i komunikimit televiziv janë pamjet si një portretizim i dimensioneve kohore dhe hapësinore të ngjarjes.

Për shkak të fuqisë dominuese ndaj mendjes, filmimet me kamera janë faktorë vendimtarë në krijimin e identifikimit emocional dhe racional, duke krijuar përshtypje, gjykime dhe opinione si mbi materialin e regjistruar, ashtu edhe atë të transmetuar. Në përgjithësi ekzistojnë dy qasje mbizotëruese të kamerës: subjektive apo personale (që përdoret në

programet artistike) dhe objektive apo raportuese (që përdoret në programet e aktualitetit). Një qasje subjektive nuk është e përshtatshme në programet e aktualitetit.

Fotografitë apo xhirimet në programet e aktualitetit janë për të reflektuar ngjarjet në mënyrë objektive. Kjo duhet t'i japë shikuesit mundësinë për të marrë një përshtypje realiste dhe të plotë të asaj që po ndodh në të vërtetë dhe që ka ndodhur. I vetmi element i pranueshëm imagjinar është kohëzgjatja. Kohëzgjatja reale e ngjarjes mund të përshtatet duke prerë dhe redaktuar materialin. Transmetimet e drejtpërdrejta të ngjarjeve përbëjnë një përjashtim.

Mjetet vizuale lejojnë portretizime të padëshiruara apo portretizime të rreme të ngjarjeve, rrethanave ose personaliteteve. Prandaj duhen konsideruar me kujdes këndet e kamerave, ndryshimet e pas-prodhimit dhe ndryshimet e përmbajtjes të shkaktuara nga aplikimi i teknologjisë. Zbatimi i këtyre procedurave mund të rezultojë në një portretizim të shtrembëruar dhe keqinterpretuar të realitetit, duke imponuar pikëpamje të njëanshme mbi audiencën.

9.9 Regjistrimi, përzgjedhja e planeve/këndeve të kamerës

Mesazhi dhe portretizimi i objekteve ose personaliteteve mund të modifikohet gjerësisht nga përdorimi i këndeve dhe planeve të kamerës. Prandaj, në programet e aktualitetit duhet treguar kujdes me përdorimin e planeve "shumë afër apo shumë larg" të kamerës, kur portretizojmë personalitete apo figura publike.

Një plan nga afër i jep shikuesit përshtypjen e një personaliteti në rritje dhe një plan nga distanca krijon efektin e kundërt.

Planet shumë të afërta dhe planet e gjera kanë një efekt të caktuar psikologjik dhe bartin ndikime të caktuara. Programet e aktualitetit duhet të tregojnë kujdes në përdorimin e tyre, pasi nuk i shërbejnë asnjë qëllimi tjetër përveçse të theksojnë tiparet dhe reagimet e personalitetit.

Objektivi i kamerës si rregull duhet të jetë në nivelin e shikimit të syrit të ftuarit/intervistuarit, veçanërisht gjatë intervistave.

Këndet e kamerës dhe teknikat që zbulojnë jetën private, detaje intime dhe reagimet e personit, mund të përdoren vetëm me miratimin paraprak nga individit që intervistohet.

9.10 Montazhi

Montazhi i materialit të regjistruar është një teknikë thelbësore dhe legjitime e gazetarisë për sa kohë që, duke përsëritur sekuenca ose duke shtuar skena jo autentike, nuk shtrembërohet pasqyrimi objektiv i ngjarjeve.

9.11 Përdorimi i teknologjisë kompjuterike pas prodhimit

Përdorimi i teknikave kompjuterike të filmit vizatimor dhe efekteve speciale mund të komprometojnë vërtetësinë dhe integritetin e materialit të regjistruar. Në programet e

aktualitetit duhet treguar kujdes me përdorimin e efekte të tilla, si: stop-kamera, lëvizje të ngadalta, ekspozim të dyfishtë ose efekte të tjera, që modifikojnë atë që është duke u transmetuar. Këto teknika mund të përdoren atëherë kur duhet të dalin në pah më shumë hollësi nga lajmi, ngjarja apo personaliteti.

9.12 Rindërtimi dhe përngjasimi i një ngjarjeje

Çdo rindërtim ose përngjasim duhet të përputhet me ngjarjen që synohet të përshkruhet. Rindërtimet apo përngjasimet përdoren shumë rrallë në edicionet e lajmeve.

Një rindërtim ose përngjasim mund të jetë mjete më efektiv për të përcjellë informacione të tilla, si eksplorimi i hapësirës apo ngjarjeve që lidhen me një aksident. Nëse një ngjarje apo pjesë e një ngjarjeje është rindërtuar ose përngjasuar gjatë transmetimit të një programi, kjo duhet të bëhet e qartë për publikun me mjete audio ose vizuale.

9.13 Materiali arkivor

9.13.a Sinjalizimi për përdorimin e materialit arkivor

Materiali arkivor në radio ose televizion përdoret për të ilustruar ngjarjet ose çështjet aktuale dhe duhet të sinjalizohet në mënyrë të qartë. Materiali arkivor nuk duhet të përdoret për të ilustruar një ngjarje në mënyrë të tillë që shikuesit dhe dëgjuesit të besojnë se kjo është një ngjarje aktuale.

9.13.b Keqpërdorimi i materialit arkivor

Përdorimi i materialit arkivor duhet të sinjalizohet qartë nëse nuk merret vesh nga konteksti i raportit, veçanërisht në lajme dhe programe mbi çështje aktuale, ku materialit arkivor duhet të etiketohet - "material arkivor" - me datën kur është regjistruar.

Nuk duhet të përdorim materialin arkivor për të ilustruar ngjarjet në mënyrë të tillë që mund të jenë çorientuese për audiencën.

Materiali arkivor në një ngjarje nuk duhet të përdoret për të ilustruar një ngjarje tjetër, në një mënyrë të tillë që shikuesit dhe dëgjuesit të besojnë se kjo është një ngjarje aktuale.

Rindërtimet nuk duhet të paraqiten si material dokumentar. Kur në një dokumentar, për shkak të mungesës së materialit autentik, përdoret një skenë e rindërtuar kjo duhet të bëhet e qartë për publikun.

Publiku nuk duhet të jetë në dyshim se ku fillon dhe ku mbaron një rindërtim.

Përsëritja e vazhdueshme e të njëjtit material për të ilustruar subjekte të ndryshme në lajme dhe programe të aktualitetit mund të jetë çorientuese, sidomos kur ajo përfshin fotografitë e personave të identifikueshëm.

9.13.c Materiali arkivor që përshkruan një krim

Ne duhet të tregojmë kujdes në përsëritjen e materialit arkivor, në lidhje me krimet ose viktimat. Çdo përdorim i materialit të tillë ka nevojë të gjykohet rast pas rasti.

Mos përdorni materialin arkivor të një krimi, për të përshkruar një tjetër.

Fotografitë/pamjet e skenës së një krimi të mëparshëm duhen përdorur rrallë për të ilustruar në seancën e ardhshme të gjyqit.

Kur zgjedhim materialin arkivor duhet të shmangim përdorimin e pavëmendshëm dhe të shpeshhtë të stereotipave në lidhje me racën, etninë, seksin etj.

9.14 Kombinimi i aktualitetit me dramatizimin

Programet gazetareske, në parim, nuk duhet të përziejnë aktualitetin (efekte audio dhe vizuale të ngjarjeve aktuale dhe njerëzve realë) me një përshkrim të dramatizuar të figurave dhe ngjarjeve reale apo historike.

Publiku duhet të jetë në gjendje të gjykojë natyrën e informacionit që konsumon.

Nëse në një situatë, një përzierje e tillë e formave është e vetmja metodë e përshtatshme për të përcjellë informacionin e nevojshëm, pjesa e dramatizuar duhet të identifikohet qartë.

9.15 Satira

Satira nuk duhet të përdoret në programet informative. Satira mund të përdoret, në raste të rralla, në shqyrtime serioze të çështjeve të rëndësishme. Përdorimi i satirës në programe, për vetë natyrën e saj, mund të çojë në konfuzion nga ana e audiencës dhe të vërë në pikëpyetje qëllimin e programit. Elementet satirike duhet të trajtohen në mënyrë të tillë në prezantim, që publiku të dallojë lehtësisht informacionin e vërtetë nga mendimet/pikëpamjet dhe informacionet e paraqitura me humor.

10. RESPEKTIMI I VLERAVE TË SHIKUESVE DHE DËGJUESVE

10.1 Pëlqyeshmëria

Programet e RTSH-së duhet të lënë shije të mirë, që do të thotë se duhet të respektojnë dhe të reflektojnë vlerat e pranuar në përgjithësi në shoqëri në lidhje me çështje të tilla, si: vulgariteti, blasfemitë apo sjelljet seksuale.

Audienca radiotelevizive është e përbërë nga grupe të ndryshme dhe konceptet mbi shijen ndryshojnë ndjeshëm mes tyre. Për këtë arsye, transmetuesi nuk mund të presë që të gëzojë të njëjtën liri të plotë të shprehjes së fjalorit apo të paraqitjes vizuale, siç e kanë, për shembull, librat, shfaqjet teatrale ose filmat, ku lexuesit dhe shikuesit bëjnë një zgjedhje të vetëdijshme në lidhje me atë zgjedhin të lexojnë apo shohin.

Megjithatë, do të ketë raste që në reflektimin e realitetit nuk mund të shmangen përdorime të caktuara të gjuhës ose përshkrimi i dhunës apo seksualitetit, që normalisht duhet të shmangen. Duke shmangur këto raste, do t'i mohonim audiencës së RTSH-së qasjen ndaj ngjarjeve të caktuara, të cilat mund të kontribuojnë për të kuptuar botën në të cilën jetojnë.

10.2 Raportimi mbi çështjet e shëndetit

Programet e RTSH-së mbi çështjet e shëndetit respektojnë si parim të përgjithshëm betimin e Hipokratit, i cili kërkon që asgjë nuk mund të ndërmerret nëse mund të ndikojë negativisht në shëndetin e pacientit. Raportimi mbi çështjet e shëndetit, për këtë arsye, duhet të respektojë parimet e mëposhtme:

- Informacioni dhe programet nuk duhet të vënë në rrezik shëndetin e shikuesve dhe dëgjuesve.
- Para transmetimit, të gjitha faktet me ndikim potencial në shëndetin e njerëzve duhet të kontrollohen me ekspertë mjekësorë, edhe pse kjo mund të çojë në vonimin e realizimit të programit. Duhet bërë kujdes mes sëmundjeve ngjitëse dhe infektuese dhe sëmundjeve që kërkojnë konfidencialitet edhe nga vetë specialistët. Duhet evidentuar rastet që mund të provokojnë panik.
- Lajmet dhe programet e tjera nuk duhet të krijojnë pritshmëri dhe shpresa të rreme se, për shembull, së shpejti do të zbulohet një "medikament i mrekullueshëm".

RTSH duhet t'i përmbahet në mënyrë rigoroze parimit të mirëbesimit të të dhënave të pacientëve dhe të dhënave të tyre mjekësore. Nuk duhet, në asnjë mënyrë, të lëndohen ndjenjat e pacientit apo dinjiteti njerëzor. Gazetarët duhet të jenë plotësisht të vetëdijshëm për faktin se transmetimi i lajmit mund të ndryshojë përgjithmonë jetën e tyre.

Gjithmonë duhet të merret parasysh se si të lehtësohet apo zbutet pikëllimi dhe ankthi i personave, veçanërisht fëmijëve dhe të sëmurëve rëndë.

RTSH duhet të respektojë privatësinë e pacientit, familjarëve dhe të afërmeve të tij.

Gazetarët e RTSH-së duhet të mbrojnë privatësinë e njerëzve edhe kur raportojnë për fatkeqësitë natyrore. Pamjet nga afër të të plagosurve, personave të sëmurë ose të infektuar, duhen shmangur nëse është e mundur.

Në rast dyshimi, nuk duhet të raportohen çështje të caktuara mjekësore.

Në çështjet e shëndetit, gazetarët nuk duhet të raportojnë informacione konfidenciale.

10.3 Raportimi i pamjeve erotike

Skena të lakuriqësisë apo erotizmit janë të pranueshme vetëm nëse janë thelbësore për informacionin që përcillet dhe kur ky informacion është i rëndësishëm për t'u transmetuar. Skena të tilla nuk duhet të theksohen ose të përdoren kryesisht për bujë, apo për të shokuar publikun. Në asnjë rast nuk duhet të çenohet privatësia dhe morali i të tjerëve, sidomos fëmijëve.

10.4 Hidhërimi dhe vuajtja

Skenat e vuajtjeve duhet të përdoren vetëm kur është e nevojshme për të kuptuar informacionin që është i rëndësishëm për publikun. Duhet treguar maturi në përdorimin e pamjeve pikëlluese. Nëse përdoren, duhen shmangur zgjatje të panevojshme. Pikëllimi i

personit mund të ketë një qëllim legjitim për programin, por kjo nuk duhet të shfrytëzohet për efekte të bujshme dhe duhet respektuar privatësia.

10.5 Dhuna

Dhuna nuk duhet të paraqitet në programet informative të RTSH-së. Është politikë e RTSH-së për të mos e përshkruar dhunën përveçse kur përshkrimi i saj është një fakt thelbësor i realitetit që është duke u përshkruar.

Paraqitja e skenave apo ngjarjeve të dhunshme duhet të jetë një pasqyrim i saktë i realitetit dhe i përshtatshëm për kontekstin e programit.

10.6 Njoftime paralajmëruese

Nëse një program përmban materiale që mund të jenë shqetësuese për disa segmente të audiencës (veçanërisht fëmijë), për shkak të skenave të dhunës, sjelljes seksuale apo gjuhës, duhet të përdoren njoftime paralajmëruese para ose gjatë programit.

10.7 Ndërprerjet e programit

RTSH mund të informojë publikun në lidhje me ngjarjet e jashtëzakonshme, pa pritur për programin e ardhshëm të lajmeve. Televizioni mund ta transmetojë informacionin me titra pa e ndërprerë programin, ndërsa radio është e detyruar ta ndërpresë. Ndërprerjet e tilla duhet të sinjalizohen në mënyrë të qartë dhe duhet të bëhen vetëm pas shqyrtimit të plotë editorial në lidhje me vlerën/rëndësinë e "lajmit të fundit", në mënyrë që të shmangen ndërprerjet e panevojshme të programeve. Vendimi për të ndërprerë programin në mënyrë që të transmetohen lajme urgjente merret nga redaktori përgjegjës, në marrëveshje me kryeredaktorin.

10.8 Karakteristika të veçanta të radios

Përveç informacioneve të përgjithshme, programet e radios ofrojnë informacion në shërbim të publikut. Këtu përfshihen informacione për trafikun, informacione mbi ngjarjet e jashtëzakonshme, mbi motin dhe informacione të tjera që transmetohen të verifikuara, në mënyrë që të parandalohet keqpërdorimi dhe manipulimi që mund t'u bëhet dëgjuesve.

11. PROGRAMET ME INTERES TË VEÇANTË

11.1 Pakicat etnike

RTSH i kushton vëmendje jetës dhe situatës së pakicave kombëtare dhe grupeve të tjera etnike që jetojnë në Shqipëri.

Si një institucion publik, RTSH duhet të respektojë të drejtat e pakicave dhe të kontribuojë në zhvillimin e tyre. Raportimi i çështjeve lidhur me pakicat etnike dhe grupet e tjera etnike duhet të jetë një nga fokuset e lajmeve dhe programeve të aktualitetit.

11.2 Shqiptarët që jetojnë jashtë

Shqiptarët që jetojnë jashtë vendit, gjendja dhe puna e tyre, duhen reflektuar në të gjitha programet e RTSH-së. Programe të veçanta për nevojat e tyre specifike dhe kontaktet me ta janë të vazhdueshme, sidomos nëpërmjet Programit Satelitor të RTSH-së.

11.3 Feja

Ceremonitë apo veprimtaritë e përvitshme fetare pasqyrohen nga RTSH gjatë festave tradicionale të tyre, pa asnjë lloj diskriminimi, në respektim të larmisë kulturore e fetare. Në mënyrë që publiku të informohet për botëkuptimin fetar të përkatësive të ndryshme fetare dhe për të vënë në pah tolerancën mes tyre, RTSH mund të ftojë, në datat e ngjarjeve të mëdha fetare, liderët e përkatësive të ndryshme fetare, për të dhënë mesazhe të shkurtra për publikun. Këto mesazhe të shkurtra duhet të transmetohen jashtë edicioneve të rregullta të lajmeve.

RTSH nuk transmeton reklama që i drejtohen një besimi fetar të caktuar ose që kanë për qëllim reklamimin e një besimi fetar apo anëtarësimin në një organizatë fetare dhe nuk bën propagandë fetare.

RTSH siguron një përfaqësim të balancuar të të gjitha komuniteteve fetare, të regjistruara në Komitetin Shtetëror për Kultet.

Njerëzit dhe shtetet nuk duhet të përcaktohen nga fetë e tyre, me përjashtim të rasteve kur kjo gjë është nevojshme.

Grupe, organizata apo sekte fetare nuk duhen përshkruar si përfaqësuese të fesë.

Fjalë të tilla si "fundamentalist", "militant" dhe "islamik" duhet të përdoren me shumë kujdes. Çfarë mund të jetë përshkrim i drejtë i një grupi, mund të mos jetë i vërtetë për të gjitha grupet e ngjashme.

11.4 Shërbimi ndërkombëtar

RTSH, në kuadrin e programeve të saj të rregullta, transmeton programe në gjuhë të huaja që synojnë audiencë ndërkombëtare.

Këtu bëhet fjalë për programe/produkte të veçanta, që kanë parasysh audiencat të cilave u drejtohen.

12. PORTRETIZIMI I GRUPEVE TË VEÇANTA TË SHOQËRISË

RTSH ka përgjegjësinë që t'i shërbejë të gjitha shtresave dhe grupeve të shoqërisë. Duke shmangur stereotipat dhe duke portretizuar një larmi të plotë të roleve/karaktereve, RTSH

duhet të ketë kujdes për rrezikun që mund të shkaktohet, duke përshkruar një shoqëri që nuk ekziston. Atje ku ekzistojnë, paragjykimi dhe prapambetja duhet të raportohen apo të reflektohen në programe, por nuk duhet të bëhet asgjë për t'i përjetësuar.

Emëruesi i përbashkët i shqetësimeve për të gjitha shtresat është përshkrimi/paraqitja e pamjaftueshme në programe. Programet e RTSH-së nuk duhet të kategorizojnë "romët" si kriminelë, gratë si shtëpiake, invalidët si viktime, homoseksualët si të padobishëm, të moshuarit si të paaftë etj. Njerëzit duhet të paraqiten në të gjitha rolet që pasqyrojnë realitetin.

12.1 Gratë

Pavarësisht ligjeve dhe ndryshimit të qëndrimeve/sjelljeve, në disa aspekte, gratë janë ende të diskriminuara. Është i papranueshëm perceptimi se disa aktivitete mund të bëhen vetëm nga një gjini. Meqenëse sot ka zgjedhje komode për pothuajse të gjitha profesionet që nuk janë seksiste, duhet të përdoren terma joseksiste.

12.2 Personat me aftësi të kufizuara

Programet duhet të shfaqin ndjeshmëri ndaj të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara, pa e humbur forcën editoriale. Njerëzit me aftësi të kufizuara nuk duhet të karakterizohen as si heronj të guximshëm, as si viktime që duhen mëshiruar. Njerëzit me aftësi të kufizuara duhet të jenë të mirëpërfaqësuar në programet e RTSH-së dhe publiku duhet sensibilizuar dhe informuar me saktësi dhe në mënyrë të paanshme mbi ndjesitë për shqetësimet dhe problemet e tyre.

Duhet të kushtohet kujdes i veçantë në mënyrë që terminologjia e përdorur të jetë moderne dhe e pranueshme nga ekspertët dhe të shmangët përdorimi i termave fyese të gjuhës së përditshme.

Termet e përshtatshme janë "aftësi të kufizuara" ose "person me aftësi të kufizuara". Për më tepër, mund të përdoren termat "i shurdhër" dhe "shurdhuar" ("shurdhmemec" vështirë se është e pranueshme), "të verbër" apo "me shikim të dëmtuar", "njerëz me kufizime në lëvizje" (duke pasur parasysh këtu "njerëzit në karrige me rrota" apo "persona që përdorin karrige me rrota"), "persona me aftësi të kufizuara" etj.

Gazetarët duhet të tregohen të përmbytshëm përdorimin e termave, si: "handikapat mendor", "i dëmtuar", "me të meta", "i gjymtuar", "i vonuar" etj.

Para intervistave dhe programeve të tjera, redaktorët duhet të konsultohen, lidhur me temën, me personin me aftësi të kufizuara dhe të pranojnë terminologjinë e propozuar. Njerëzit me aftësi të kufizuara zakonisht nuk përpiqen t'i fshehin kufizimet e tyre dhe mund të flasin hapur. Redaktorët duhet të respektojnë dëshirën e disa grupeve të njerëzve me aftësi të kufizuara, që edhe të tjerët të përdorin terminologji të veçantë.

Kur u referohen fëmijëve me aftësi të kufizuara, gazetarët duhet të flasin për "fëmijë me nevoja të veçanta". Në të njëjtin kontekst përdoren shprehjet "fëmijë të shurdhër dhe me

vështirësi dëgjimi", "fëmijë të verbër dhe me dëmtime shikimi", "fëmijë me sjellje dhe çrregullime të personalitetit", "fëmijë me çrregullim në të folur" etj.

Njerëzit me aftësi të kufizuara duhet të jenë në gjendje të hyjnë në mjediset dhe studiot ku zhvillohet programi dhe duhet të prezantohen në program ashtu si ata dëshirojnë.

12.3 Pakicat gjinore

Homoseksualët mund të jenë, veçanërisht, objekt i stereotipave të pamenduara dhe fyese. Këta stereotipa mund të konsolidohen akoma më shumë nëse programet i lejojnë supozimet fyese ose përgjithësit. Pasqyrimi me vërtetësi mund të ndihmojë në ndryshimin e stereotipave. Në përshkrimin e seksualitetit duhet të shmangët thjeshtëzimi, klishetë dhe gjykimi personal. Marrëdhëniet homoseksuale duhet të portretizohen me saktësi dhe paanësi krahasuar me marrëdhëniet heteroseksuale.

Gazetarët duhet të tregohen të ndjeshëm ndaj efektit të gjuhës. Nuk duhet të ngatërrohet homoseksualiteti me transvestizmin apo transeksualizmin.

12.4 Njerëzit e moshuar

Programet e RTSH-së i kushtojnë vëmendje të veçantë përshkrimin të të moshuarve. Qëllimi është të ndihmojnë që të formësohet një qëndrim publik i drejtë ndaj numrit gjithmonë e në rritje të të moshuarve. Këtu përfshihen programe që synojnë grupmoshën e tretë, si edhe programe ku ata marrin pjesë si konkurrentë, garues apo artistë.

Gjithnjë e më shumë të moshuarit po bëjnë jetë energjike dhe të shëndetshme. Imazhi/perceptimi/përshkrimi se ata jetojnë të mënjanuar, të brishtë dhe pasivë, nuk është në përputhje me realitetin, ndaj duhen përshkruar me realizëm.

13. FËMIJËT DHE TË RINJTË NË PROGRAMET E RTSH-së

Fëmijët mund të përfshihen në programe në mënyra të ndryshme: si aktorë, të intervistuar, pjesëmarrës në programe ose subjekte të një programi dhe madje, herë pas here, si prodhues programesh. Pjesëmarrja e fëmijëve në programe shpesh kërkon trajtim me kujdes të madh: mund të jetë e vështirë për prodhuesit e programeve arritja e ekuilibrit ndërmjet interesave konkurruese të fëmijës, të prindit (prindërve) dhe të audiencës si një e tërë.

Gjithashtu duhet të respektohet interesi i fëmijëve si shikues dhe dëgjues të programeve të RTSH-së, nëse këto programe u janë drejtuar atyre në mënyrë të veçantë apo qoftë edhe një audience më të përgjithshme.

Duhet të kërkohet pëlqimi i prindërve, ose kujdestarëve, para se të intervistohen fëmijët, ose të angazhohen në programe. Sa më të vegjël e më të prekshëm fëmijët dhe sa më e ndjeshme të jetë tema që do të trajtohet, aq më i detyrueshëm është pëlqimi paraprak i prindërve. Nëse fëmijët duhet të marrin pjesë në program gjatë orëve të mësimin është normalisht e nevojshme të kërkohet pëlqimi/leja e shkollës.

Kur pëlqimi refuzohet, duhet të njoftohet kryeredaktori para se të merret ndonjë vendim tjetër.

Gazetarët dhe autorët e programeve duhet të shqyrtojnë me kujdes ndikimin që ka emisioni te një fëmijë i përfshirë në të, si në mënyrën e realizimit, ashtu edhe ndikimet e mundshme që mund të ketë kur të transmetohet programi.

Autorët e programit mund të kenë nevojë për t'u konsultuar me profesionistë dhe ekspertë, kur kanë të bëjnë me fëmijët.

Kur kanë të bëjnë me fëmijë të përfshirë në aktivitete të rrezikshme ose të paligjshme, të tilla si marrja e drogës apo prostitucioni, shpesh është e këshillueshme që ekipet e programit të shoqërohen nga ekspertë të pavarur, punonjës socialë, ose psikologë, gjatë gjithë kontaktit të tyre me fëmijët.

Kur programet e aktualitetit paraqesin fëmijë të përfshirë në veprimtari të paligjshme, identifikimi mund të ngrejë çështje të vështira etike. Identifikimi i fëmijëve në fjalë mund të jetë në interes të publikut, por duhen pasur parasysh edhe interesat afatgjata të fëmijëve. Autorët e programit duhet t'i referohen eprorit kur kanë dyshime për vendimin që duan të marrin. Pëlqimi i prindërve nuk mund të jetë arsye e mjaftueshme për të identifikuar një fëmijë, nëse anonimati i shërben më mirë të ardhmes së fëmijës.

Kur regjistrohen praktika të paligjshme dhe kriminale nga fëmijët, me qëllim për të theksuar më shumë praktikën sesa individët, rregulli i përgjithshëm është që fëmijët nuk identifikohen.

Intervistat me fëmijë kërkojnë kujdes të veçantë. Fëmijët mund të manipulohen nga pyetjet dhe shpesh janë të hapur ndaj sugjerimeve. Fëmijët e vegjël në mënyrë të veçantë mund të kenë vështirësi në dallimin midis realitetit dhe fantazisë. Përgjegjësit e programit duhet të jenë të kujdesshëm dhe t'i lejojnë fëmijët të flasin vetë. Fëmijëve nuk u duhet folur me ton, por as nuk duhen përfillur më shumë seç është e nevojshme.

Çdo gjë që çon në identifikimin, gjatë një procedure gjyqësore të një dëshmitari, të të pandehurit ose çdo pale tjetër, që është nën moshën 18 vjeç, nuk mund të bëhet publike. Kufizimet përfshijnë emërtimin e shkollave dhe të adresave. Pamjet e të miturve nën 18 vjeç nuk mund të transmetohen. Një fëmijë i përfshirë në procedurën penale si i pandehur (i njohur si "i akuzuar"), si viktimë apo si dëshmitar nuk mund të identifikohet në raportim.

E njëjta gjë vlen edhe për procedurat e kujdestarisë, adoptimit dhe çështje të ngjashme.

Fëmijët që janë viktimë të dhunës seksuale nuk duhet të identifikohen.

Zakonisht është shpërfillje ndaj gjykatës, transmetimi me pamje i seancave të çdo gjyqi që zhvillohet me dyer të mbyllura. Këtu përfshihen birësimet dhe kujdestaria e një të mituri.

RTSH ka të drejtë të mos transmetojë asnjë material për fëmijë (audio/video) që konsiderohet si i padenjë apo poshtëruar (p.sh. fëmijë lakuriq apo në situata poshtëruese).

Në çdo rast, në programet e RTSH-së, respektohet maksimalisht interesi më i lartë i fëmijës.

14. NDËRHRYJET

14.1 Kërkesat ndaj RTSH-së për të mos transmetuar materiale

Materiali i regjistruar në përputhje me politikat editoriale mund të përdoret për t'u transmetuar me kusht që çdo ndërhyrje nuk tejkalon nevojat e programit dhe nuk ka pasur asnjë marrëveshje tjetër në kohën e regjistrimit.

Është e rëndësishme të ushtrohet gjykim i shëndoshë për të balancuar arsyet e një kërkesepër mostransmetim material, përkundrejt rëndësisë të programit. Arsyet për mostransmetimin e një materiali mund të jenë të karakterit humanitar ose thjesht për humbjen e aktualitetit, ndërkohë që mund të ketë ndryshuar konteksti. Kërkesat për mostransmetim i drejtohen përgjegjësit të programit.

Nëse kërkesa për të mos transmetuar materialin është bërë pasi ai është regjistruar me dëshirë, producentët dhe eprorët duhet të marrin parasysh natyrën e marrëveshjes së bërë në kohën e regjistrimit. Nëse përdorimi i parashikuar i materialit është në përputhje me marrëveshjen e bërë, nuk duhet marrë parasysh kërkesa për mostransmetim.

Gjithmonë duhen bërë përpjekje për të shpjeguar pozitën e RTSH-së.

14. 2 Vetoja mbi emisionin nga të ftuarit

Pjesëmarrësve në programe nuk do t'u jepet e drejta e vetos për ndonjë pjesë të programit.

Përgjegjësia për programin e RTSH-së është e patransferueshme. RTSH është e vetmja përgjegjëse për atë që transmeton dhe për të garantuar që programet janë në përputhje me politikat e saj editoriale.

Pjesëmarrësit e ftuar do të kenë pikëpamje të caktuara mbi temën e programit dhe të rrolit/opinionit të tyre mbi çështjen. RTSH nuk duhet ta ekspozojë veten ndaj presioneve të një ose më shumë pjesëmarrësve. Kjo mund të çojë në padrejtësi dhe humbje të balancës së programit.

14. 3 Censura

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën për informim të lirë dhe të pavarur, çdo lloj censure është e paligjshme. Redaktorët dhe gazetarët e RTSH-së nuk duhet të dorëzohen para çdo lloj presioni, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për të censuruar programet e tyre. Për më tepër, ata nuk duhet të bien në vetëcensurë, sepse konformizmi nuk ka asgjë të përbashkët me gazetarinë e pavarur. Kujdesi i veçantë që duhet të tregohet gjatë transmetimit të informacioneve jozyrtare nga interneti nuk mund të barazohet me censurën. Kur materiali i një programi është prekur si pasojë e censurës, autoritetet, redaktorët dhe gazetarët ose autorët e programeve do ta identifikojnë këtë gjë në transmetim. Kur kufizime të tilla kanë ndikuar në raportimin e gazetarëve, kjo duhet të silllet në vëmendjen e audiencës gjatë kohës së transmetimit.

15. E DREJTA PËR KORRIGJIM

RTSH nuk do të hezitojë ta pranojë një gabim kur është e vërtetuar se e ka kryer një të tillë. Veprimi ndryshe apo mbrojtja e një programi që ka shije të varfër, etikë të papranueshme ose që përmban gabime, çon në mënyrë të pashmangshme në humbjen e besueshmërisë. Gabimet duhet të korrigjohen menjëherë në mënyrë që të ruhen parimet e saktësisë dhe ndershmërisë. Për të përcaktuar natyrën dhe kohën e korrigjimit nevojitet konsultimi me kryeredaktorin e lajmeve dhe programeve të çështjeve të aktualitetit. Korrigjimi do t'u referohet fakteve të pasakta dhe nuk mund të jetë më i gjatë në kohë sesa materiali që përgënjeshtrohet.

Një korrigjim mundet, në disa rrethana, të përfshijë heqje të materialit nga arkiva dhe publikimet apo edhe kërkim ndjese.

16. KUJDESTARI I STANDARDEVE EDITORIALE, PROFESIONALE DHE I PARIMEVE TË ETIKËS GAZETARESKE

Kujdestari mbikëqyr zbatimin e standardeve editoriale, profesionale dhe parimeve të etikës gazetareske të përcaktuara në këtë dokument.

Për më tepër, kujdestari mbron interesat e taksapaguesve, si dhe ato të gazetarëve dhe krijuesve të programeve radiofonike dhe televizive kundër ankesave të pabaza dhe kritikave dhe kundër masave të pabazuara të ndërmarra nga redaktorë individualë.

Në përputhje me dispozitat ligjore mbi të cilat funksionon RTSH, dëgjuesit dhe shikuesit duhet t'u drejtohen së pari kryeredaktorëve të programeve individuale të radios dhe të televizionit me ankesat, propozimet dhe sugjerimet e tyre. Nëse nuk janë të kënaqur me përgjigjet apo veprimet e tyre, ata mund të ndjekin shqetësimin më tej me kujdestarin e standardeve editoriale, profesionale dhe parimeve etike.

Kujdestari vepron si një "regjistër" i ankesave, nismave dhe hulumtimeve të shikuesve dhe dëgjuesve dhe atyre të punonjësve të RTSH-së; përveç kësaj, kujdestari mund të fillojë procedurat me nismën e tij. Kujdestari duhet të vendosë, në fazën fillestare të çdo procedure, nëse janë shkelur dhe cilat janë shkelur nga standardet dhe parimet etike të RTSH-së. Kujdestari ia raporton konkluzionet e veta individit, apo institucionit/organizatës, që ka parashtruar ankesën, nismën apo hetimin, si dhe drejtorëve të programeve audiovizive dhe kryeredaktorëve të programeve që kanë shkaktuar shkeljen.

Në rastet kur provohet që një program ka shkelur standardet editoriale, profesionale dhe parimet e etikës dhe rasti është me interes shumë më të madh për publikun sesa vetëm për ankuesin, është detyra e kujdestarit t'i bëjë ato publike.

17. REFERENCAT E DETYRUESHME

Të gjitha materialet audio dhe audiovizive duhet të jenë në përputhje me renditjen dhe planin programor.

Gazetarët, redaktorët dhe krijuesit e tjerë të RTSH-së duhet të informojnë kryeredaktorët për punën e tyre e të konsultohen me ta për çështjet që diskutohen gjerësisht nga publiku. Në rast se raportimi i çështjeve të tilla bie ndesh me parimet editoriale dhe etike të RTSH-

së, vendimi final për mënyrën se si do të veprojnë më tej gazetarët dhe redaktorët si dhe për transmetimin apo jo të materialit, merret nga kryeredaktori i programit.

Gazetarët duhet të respektojnë vendimet editoriale të kryeredaktorit edhe në rastet e papajtueshmërisë mes tyre, por gazetari ka të drejtë të kërkojë nga kryeredaktori që ta vlerësojë dhe ta hedhë në diskutim edhe më të gjerë mendimin kundër tij.

Në dritën e parimeve të hierarkisë, redaktorët nuk janë të autorizuar për të ndryshuar, përshtatur apo shkurtuar materiale në mënyrë të konsiderueshme, pa pëlqimin e gazetarëve.

Gazetarët dhe prodhuesit e tjerë të programit duhet të konsultohen dhe t'u referohen redaktorëve të tyre, të cilët nga ana e vet informojnë dhe konsultohen me kryeredaktorët.

18. NDIHMA LIGJORE PËR GAZETARËT DHE REDAKTORËT

Është përgjegjësi e RTSH-së që të ofrojë këshilla ligjore për gazetarët dhe redaktorët, edhe nëse ata kanë shkëlur standardet profesionale dhe parimet etike, apo ligjet e Republikës së Shqipërisë ose vendit prej nga raportojnë. Por, RTSH ka të drejtë të mos e ofrojë këtë ndihmë nëse punonjësi qëllimisht dhe në mënyrë të hapur i ka kryer shkeljet ligjore dhe parimet e parashtruara në këtë dokument.

Këshillat ligjore ofrohen në mënyrë që të parandalohen rastet në të cilat mund të rrezikohen parimet e saktësisë, paanshmërisë dhe besueshmërisë së programeve të RTSH-së apo kur mund të shkaktohen humbje financiare apo materiale, si dhe dëmtim i reputacionit të një individi apo gjithë institucionit të RTSH-së.

Për të shmangur krijimin e përshtypjes së anësisë në favor të punonjësve të saj, drejtuesit e RTSH-së mund të sigurojnë ndihmën juridike edhe nga ekspertë të pavarur, juristë dhe avokatë të respektuar.

19. REKLAMA, PROMOVIMI DHE SPONSORIZIMI NË PROGRAMET E RTSH-së

19.1 Kriteret etike të reklamave

Programet e RTSH-së do të transmetojnë vetëm reklamat që janë në përputhje me ligjin.

Mesazhet e përcjella në reklama duhet të jenë të vërteta. Transmetimi i reklamave mashtruese është joetik dhe i paligjshëm.

Çmimet e deklaruar duhet të jenë të sakta dhe jo çorientuese për konsumatorët.

Reklamat nuk duhet të krahasojnë produkte të ndryshme.

Reklamat e paplota dhe ato për një produkt ose shërbim që mund të jetë mashtrues për konsumatorët e mundshëm, nuk duhen transmetuar.

Reklamat nuk duhet të jenë kundër shijes së mirë, si dhe kundër ndjenjave fetare dhe ndjenjave të tjera, të shikuesve dhe dëgjuesve.

Reklamat që synojnë fëmijët duhen parë me kujdes të veçantë; ato nuk duhet të përmbajnë elemente që mund të rrezikojnë shëndetin e tyre, sigurinë apo edukimin. Të njëjtat kritere zbatohen për reklama që shfaqin fëmijët apo shfrytëzimin e tyre.

Transmetimi i reklamave që nuk përputhen me këto kritere do të refuzohet.
RTSH do të bëjë çdo përpjekje për të mbështetur projektet dhe shoqatat humanitare.

19.2 Reklammat dhe materiamet promovuese

Programet e RTSH-së do të transmetojnë reklama tregtare në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligj.

Transmetimi i reklamave mund të urdhërohet vetëm nëpërmjet Drejtorisë së Marketingut të RTSH-së. Me përjashtim të Drejtorisë së Marketingut, asnjë departament tjetër nuk lejohet të autorizojë reklammat tregtare në programet e RTSH-së.

Drejtoria e Marketingut do të vlerësojë, atëherë kur do të fillojë një reklamë tregtare në programet e saj, pajtueshmërinë e përmbajtjes së saj, përshkrimin, komunikimin dhe aspektet teknike me kriteret e Kodit të Reklamimit, me ligjin dhe/ose statutin e RTSH-së, me rekomandimin e Këshillit të Europës dhe konventat ndërkombëtare.

Transmetimi i një reklame që i plotëson të gjitha kriteret nuk mund të parandalohet.

Drejtoria e Marketingut duhet të refuzojë transmetimin e një reklame tregtare atëherë kur:

- përmbajtja nuk është në përputhje me dispozitat ligjore;
- reklama nuk është në përputhje me parimet programore të RTSH-së;
- përmbajtja apo përshkrimi shkel konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve;
- reklama përpiqet të kërkojë drejtpërdrejt blerjen e produktit të reklamuar;
- reklama përcjell një mesazh fyes për një person juridik, privat apo RTSH-në;
- përmbajtja e reklamës (teksti, muzika apo figura) prek dinjitetin e një individi apo grupi shoqëror;
- reklama bind apo nxit shikuesit apo dëgjuesit për të vepruar në një mënyrë që mund të rrezikojnë shëndetin e tyre, sigurinë apo jetën e individëve ose grupeve sociale;
- reklamën veprimtari që rrezikojnë mjedisin;
- është në kundërshtim me normat e vendosura dhe vlerat kulturore;
- abuzon, fyen ndjenjat fetare ose bindjet politike të individëve apo grupeve sociale;
- mesazhi propagandon mungesë tolerance fetare, racore, të moshës apo ndjenjave kombëtare;
- portretizon dhunë ose skena pornografike në një mënyrë të tillë që mund të kuptohet si nxitje për sjellje të pahijshme në shoqëri dhe mjedise publike;
- shpif, diskrediton ose fyen kompanitë, organizatat ose shoqata, si dhe institucionet qeveritare dhe përfaqësuesit e tyre;
- reklamën një produkt apo shërbim të paligjshëm;
- klienti që porosit reklamën nuk është i regjistruar për biznesin që reklamën;
- reklamën një transmetues në konkurrencë të drejtpërdrejtë me RTSH-në;
- nuk i pranon apo nuk vepron në përputhje me kushtet kontraktuale apo vepron kundër kushteve të biznesit të RTSH-së;
- kompania ose njëri prej anëtarëve të saj individualë ka detyrime ndaj RTSH-së;
- RTSH është e përfshirë në procedura ligjore kundër klientit, për shkak të detyrimeve të papaguara;

- hapësirat për reklama në programe janë tashmë të zëna (të shitura);
- klienti nuk e dorëzon materialin me kohë;
- klienti nuk e paraqet qartë një porosi të përcaktuar;
- materiali i regjistruar i reklamës nuk është në përputhje me standardet teknike të RTSH-së;
- veprimtaria ose reklama nuk është etiketuar (emërtuar) siç kërkohet;
- tekstit të reklamës nuk i është bërë korrektim letrar.
- reklama përmban përdorim të paautorizuar të materialeve të RTSH-së;
- reklamoni linja telefonike që ofrojnë shërbime seksuale apo të parashikimit të fatit.

Drejtorja e Marketingut është përgjegjëse për reklamimin dhe promovimin në teletekst, faqet e internetit të RTSH-së dhe aplikacionet mobile.

Përgjegjësia për reklamat e transmetuara në programet e RTSH-së i përket Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së apo përfaqësuesit të tij të autorizuar.

Klienti është përgjegjës për autenticitetin e përmbajtjes.

RTSH nuk lejon reklamimin e fshehtë në programet e saj, duke përfshirë edhe nxjerrjen e qëllimshme në pah të produkteve, shërbimeve ose kompanive në programe.

Përmendja e një produkti (marke) ose shërbimi në programe të destinuara për të rritur shitjet konsiderohet reklamë.

Rastet e mundshme të reklamave të fshehura në programet e RTSH-së duhet të gjykohen nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

19.3 Reklamat për fondacionet, shoqatat humanitare dhe thirrjet për bamirësi

RTSH ofron pa pagesë reklama për organizatat humanitare dhe thirrjet për ndihmë.

Fondacionet dhe organizatat humanitare që nënshkruajnë një marrëveshje me RTSH kanë të drejtë për reklama pa pagesë. Departamenti i Marketingut do të hartojë rregullore për kohën e transmetimit të njoftimeve/reklamave të organizatave humanitare. Këto organizata/shoqata duhet të paraqesin dokumente dhe prova të punës së tyre humanitare.

Edhe organizatave me karakter kulturor, shkencor, profesional dhe sportiv mund t'u ofrohet hapësirë pa pagesë për reklama.

Njoftime/reklama pa pagesë mund të bëhen për fushata ndërgjegjëse, për çelje fondesh për zonat e përmytura nga katastrofat apo fatkeqësitë natyrore.

RTSH u jep prioritet organizatave humanitare që ndihmojnë individët, grupet në nevojë si dhe njerëzit me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

19.4 Transmetimi i materialit të marrëdhënieve publike

Drejtorja e Marketingut në RTSH u ofron klientëve tregtarë mundësinë për të transmetuar mesazhe promovionale specifike (marrëdhënie me publikun). Përgjegjësia në lidhje me vërtetësinë e përmbajtjes i takon klientit.

Si mesazhe specifike konsiderohen të gjitha kontributet me qëllim krijimin ose rritjen e reputacionit të një subjekti tregtar apo kompanie duke paraqitur biznesin e tij, por që nuk kanë për qëllim rritjen e shitjeve të një marke apo shërbimi të caktuar.

Partitë politike apo organizatorët e fushatave zgjedhore nuk kanë të drejtë të porosisin transmetimet e këtij lloji.

Mesazhet specifike promociionale nuk duhet të shfaqin individët në mënyrë të tillë që të rrisin reputacionin e tyre individual ose të promovojnë çështje politike apo fetare.

Mesazhet specifike promociionale u nënshtrohen të njëjtave kufizime si reklamat e tjera komerciale në programet e RTSH-së.

Mesazhe të tilla nuk mund të transmetohen në lajmet dhe çështjet e aktualitetit.

Shkeljet e kësaj dispozite duhet të gjykohen nga kryeredaktori.

19.5 Gazetarët, prezantuesit dhe redaktorët që shfaqen në reklamat dhe programet promovuese

Redaktorët, gazetarët dhe prezantuesit e programeve të RTSH-së nuk lejohen të shfaqen në reklama tregtare dhe mesazhet promovuese, si dhe nuk lejohen të kontribuojnë në krijimin e reklamave (në bashkëpunim me agjenci reklamash ose marrëdhëniesh me publikun).

Drejtuksi i Programeve mund të lejojë përjashtime për praninë në reklama për organizatat humanitare.

Këto dispozita nuk zbatohen për shfaqjen në promocionin e programeve të RTSH-së.

19.6 Sponsorizimi në programe

Dispozitat ligjore lejojnë sponsorizimin e programeve të RTSH-së. Në rastet e sponsorizimit të programeve zbatohen këto kritere:

- sponsorizimi i secilit prej programeve të RTSH-së nuk do të ketë asnjë ndikim në integritetin profesional të tij, autonominë apo pavarësinë financiare;
- sponsorizimi i programeve të aktualitetit, për shkak të ndjeshmërisë së çështjeve, ka nevojë për autorizim paraprak të Drejtuesit të Programeve;
- RTSH ka të drejtë të marrë pjesë në tenderë për t'iu përgjigjur kërkesave për të aplikuar për fondet publike;
- emrat dhe titujt e sponsorëve duhet të publikohen në titrat e fundit të programit të sponsorizuar.

Afrimi i sponsorëve për programet individuale të RTSH-së është përgjegjësi e Drejtorisë së Marketingut. Formatet që paraqesin imazhin dhe mesazhin e sponsorit duhet të përcaktohen nga kryeredaktorët.

Transmetimi i mesazheve të sponsorizuara duhet të jetë në përputhje me dispozitat dhe standardet e reklamave.

Negociatat e biznesit me sponsorët duhet të kryhen vetëm nga përfaqësuesi i autorizuar i Drejtorisë së Marketingut.

Sponsorizimi i programeve të bashkëprodhuara nga RTSH dhe prodhues të tjerë duhet të përcaktohet në kontratat përkatëse të sponsorizimit, ku përcaktohen kriteret, formatet, përmbajtja dhe vlerat për çdo sponsor veç e veç.

20. PARAQITJA NË TRANSMETIM DHE KODI I VESHJES

Punonjësit e RTSH-së që dalin në transmetim, si edhe ekipet që veprojnë në terren, duhet të kujdesen për pamjen e tyre. Kur raportojnë ngjarje formale (seanca mbledhjesh, kongrese, ekspozita) dhe kur organizojnë debate në studio, prezantuesit dhe gazetarët duhet të paraqiten me veshje formale. Kur raportojnë ngjarje në natyrë apo në vendngjarje ku ka kriza, kodi i veshjes mund të mos respektohet në mënyrë strikte. Punonjësit që shfaqen në programet e tjera duhet të vishen në përputhje me konceptin e programit.

Drejtori i imazhit do të jetë përgjegjës për vendosjen e rregullave të qarta lidhur me veshjen në transmetim.

21. KONFLIKTI I INTERESIT, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Gazetarët, redaktorët dhe autorët e programeve të RTSH-së nuk mund të përdorin pozicionin e tyre në institucion ose të veprojnë në mënyrë të tillë që të cenojnë saktësinë, paanësinë dhe besueshmërinë e programeve të RTSH-së. Ata nuk duhet të rrezikojnë reputacionin e individëve ose institucionit apo të tradhetojnë besimin e dëgjuesve dhe shikuesve të programeve të RTSH-së si rrjedhojë e angazhimit të tyre publik dhe politik, aktiviteteve të tyre në kohën e lirë, investimeve të tyre private apo interesave financiare.

Përdorimi për interesa private apo përfitim financiar, si dhe përdorimi për përfitim nga një palë e tretë, i emrit, të dhënave, pronësisë intelektuale, pajisjeve teknike apo pajisjeve të tjera të RTSH-së, nuk lejohet pa autorizim.

Askush nuk lejohet të veprojë kundër interesave të RTSH-së duke kopjuar, apo hequr materiale audio, video ose grafike apo programe kompjuterike të krijuara, të prodhuara nga RTSH apo në pronësi të saj, për t'i përdorur në favor të transmetuesve të tjerë, prodhuesve të pavarur apo grupeve të tjera të interesuara.

21.1 Konflikti i interesave financiare dhe të biznesit

Nëse një punonjësi, në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në RTSH, i duhet të marrë një vendim që përfshin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, anëtarët e familjes dhe të afërmit, apo një vendim që ka lidhje me çështje biznesit që përfshijnë një të afërm apo edhe partnerët e biznesit të RTSH-së që mund të jenë në marrëdhënie konkurruese me të afërmit e punonjësit, atëherë nuk është ai punonjës që duhet ta marrë vendim për çështjen në fjalë. Kjo dispozitë përfshin drejtuesit e RTSH-së, kryeredaktorët dhe redaktorët dhe partnerët e tjerë që kanë të afërm, të cilët punojnë në prodhimin e programeve dhe në sektorët teknikë të prodhimit të RTSH-së, si dhe në fushën e marketingut.

Të punësuarit, në kohën e tyre të lirë, nuk mund të punojnë për organizatat që RTSH i konsideron konkurrencte. Nëse e bëjnë një gjë të tillë, ata kryejnë veprimtari kundër reputacionit dhe interesave të RTSH-së. Kjo përfshin radio dhe televizione konkurrencte, kompani prodhimi radio dhe TV, ose kompani kompjuterësh dhe programesh kompjuterike, botues, agjenci lajmesh.

Punonjësit e RTSH-së, në kohën e tyre të lirë, nuk mund të përdorin aftësitë e tyre profesionale për trajnimin e personelit në kompanitë apo institucionet konkurruese.

Këto dispozita nuk zbatohen në rastet kur:

- të punësuarit janë të përfshirë në kërkimin shkencor të kryer nga universitete/fakultete vendase ose të huaja;
- marrin pjesë si ekspertë në seminare apo kongrese profesionale ose punojnë në shoqata kombëtare apo ndërkombëtare profesionale dhe organizata jofitimprurëse.

Për më tepër, dispozitat nuk aplikohen në rastet e angazhimit artistik, angazhimit shkencor në universitetet dhe institutet publike, në rastet e ofrimit të ekspertizës në gjykatë ose aktiviteteve të bamirësisë për shoqata jofitimprurëse që nuk veprojnë kundër reputacionit të RTSH-së.

RTSH nuk njuh asnjë shpenzim që punonjësit e saj mund të kryejnë për aktivitete që nuk kanë lidhje me institucionin. Asnjë punonjës nuk lejohet të përdorë kapacitetet e RTSH-së për aktivitete që nuk kanë lidhje me institucionin.

21.2 Paraqitja dhe pjesëmarrja në mediat audiovizive konkurrencte

Punonjësit e RTSH-së mundet të marrin pjesë, nëse miratohet paraprakisht nga eprorët e tyre, në programet e radiove dhe televizioneve rivale dhe në media të tjera elektronike, si:

- të intervistuar në programet e aktualitetit, në programet që paraqesin punët e tyre artistike, publicistike apo shkencore;
- si dëshmitarë në dokumentarë dhe programe arsimore;
- si anëtarë jurie apo spektatorë në programe argëtuese, me kusht që puna e punonjësit nuk do të përmendet.

21.3 Aktivitetet tregtare

Kur blihen pajisje apo shërbime apo lidhen kontrata mbi bashkëpunime programore, teknike apo biznesi, RTSH jo vetëm që duhet të veprojë në përputhje me ligjin, por duhet të ndërmarrë hapa për të mbrojtur interesat e biznesit dhe reputacionin e vet.

Punonjësit nuk duhet të kenë ndonjë lidhje biznesi ose familjare me kompani apo individë jashtë RTSH-së që janë të angazhuar ose kanë ndonjë lidhje me produktet ose kontratat e shërbimeve me RTSH.

Punonjësve të RTSH-së që janë të angazhuar në aktivitete të tilla u kërkohet të mbrojnë interesat e biznesit dhe informacionet konfidenciale, si dhe të sigurojnë mundësi të barabarta për furnizuesit e materialeve.

21.4 Gazetaria financiare

Prodhimi i programeve për çështjet ekonomike dhe të biznesit duhet të jetë veçanërisht i ndjeshëm ndaj konflikteve të mundshme të interesit. Punonjësit e RTSH-së nuk mund të zotërojnë aksionet që kalojnë masën 1% në kompanitë apo korporatat për të cilat shkruajnë/raportojnë dhe nuk duhet të kenë anëtarë të familjes ose të afërm në bord ose nivele administrative të këtyre kompanive. Administrata e RTSH-së duhet të bëjë çdo përpjekje për t'u siguruar se asnjë nga autorët e programeve nuk është i ndikuar nga interesat financiare.

21.5 Dhuratat, përfitimet dhe shpërblime të tjera të veçanta

Punonjësit e RTSH-së duhet të refuzojnë dhurata, përfitime apo shpërblime të tjera të veçanta të ofruara nga kompanitë, organizatat apo individët për të ndikuar në raportimin e tyre apo punë të tjera, duke neglizhuar standardet profesionale të saktësisë, paanësisë së programeve të RTSH-së apo biznesit ose interesave të tjera të institucionit. Punonjësit duhet të refuzojnë mallra, ulje çmimi, shërbime, të holla, shpërblime apo zbavitje që tejkalojnë rregullat e mikpritjes në biznes (si drekat e punës ose dhurata me vlerë modeste).

Këto kufizime nuk zbatohen për pranimin e objekteve me çmim më të lirë, të dhëna për profile të caktuara profesionale që nuk kanë lidhje me punëdhënësit.

Si rregull i përgjithshëm, RTSH financon shpenzimet e udhëtimit të punonjësve të saj. Drejtorët e programeve mund të lejojnë përjashtime kur udhëtimi është financuar nga një institucion qeveritar apo kompani, me kusht që këto të fundit, në asnjë mënyrë, nuk ndërhyjnë në integritetin profesional dhe pavarësinë e raportimit. Financimi i tillë duhet të përmendet në titrat e programit.

Punonjësit duhet të refuzojnë dhuratat që tejkalojnë vlerën prej 10.000 lekësh. Në qoftë se refuzimi i një dhurate të tillë nuk është i mundur për arsye protokollare apo të ngjashme, dhurata duhet të transferohet në pronësi të RTSH-së.

Punonjësit nuk lejohen të përdorin privatisht apo të testojnë automjetet që i ofrohen si promovim RTSH-së.

Çmimet e fituara në festival, gara apo veprimtari të tjera kombëtare ose ndërkombëtare i përkasin, si rregull, autorit apo grupit të prodhimit (sipas rregullave të pjesëmarrjes). Nëse çmimi i jepet RTSH-së dhe ka përfitim financiar, njoftohen autorët dhe grupi i prodhimit dhe kthehen paratë e çmimit.

Autorët dhe producentët që kanë fituar çmime duhet të njoftojnë drejtorin e përgjithshëm të RTSH-së për këtë. Rregullat për çmimet vjetore parashikojnë vlerësim financiar për programin dhe për arritjet individuale profesionale dhe teknike.

21.6 Veprimtaritë politike, sindikaliste dhe profesionale

Punonjësit e RTSH-së janë të lirë për t'iu bashkuar organizatave politike apo sindikaliste. Papajtueshmëria e funksioneve politike dhe editoriale apo administrative është e rregulluar në ligjin dhe/ose Statutin e RTSH-së.

Asnjë punonjës i RTSH-së nuk mund të dënohet, ndaj tij/saj nuk mund të ndërmerren procedura disiplinore nëse aktiviteti i tij/saj politik, sindikalist apo profesional nuk ndërhyjnë në përgjegjësitë dhe proceset e punës dhe nuk shkel dispozitat ligjore mbi propagandën politike.

Nëse punonjësit e RTSH-së do të kandidojnë për një vend në zgjedhjet lokale, në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, apo funksione të tjera të përcaktuara me ligj elektoral, duhet të informojnë eprorin e tyre në kohën e duhur. Rasti më i vonë është momenti i paraqitjes së kandidaturës.

Një punonjës konsiderohet që po merr pjesë në një fushatë zgjedhore, kur shfaqet në listën e miratuar të kandidatëve nga një subjekt politik, apo si kryetar, apo moderator i kuvendeve të partive, apo kur shfaqet në reklama zgjedhore ose programe promovuese.

Gjatë periudhave zgjedhore, kandidatët nuk lejohen të shfaqen në programet e RTSH-së (me përjashtim të programeve të fushatës zgjedhore të përcaktuara me ligj dhe rregullat mbi programet e fushatës zgjedhore të RTSH-së). Gjatë kësaj periudhe punonjësit nuk i lejohet të kryejnë detyrat e redaktorit, gazetarit apo prezantuesit.

Gjatë fushatave zgjedhore kandidatët janë të detyruar të marrin leje pa të drejtë page.

Ndryshimet e mundshme në kontratat e punësimit për shkak të zgjedhjes së një kandidati në një post profesional, politik apo qeveritar janë të përcaktuara me ligj.

Anëtarësia dhe çdo përfshirje në organizatat që veprojnë fshehurazi nuk është e lejueshme dhe përbën shkelje të rëndë.

22. MEDIA ONLINE, MEDIA SOCIALE DHE KONTRIBUTET E AUDIENCËS

Rrjetet sociale janë një mjet i rëndësishëm i transmetuesit për mbledhjen e materialeve, për gjetjen e burimeve dhe për të komunikuar me audiencën. Por duhet treguar kujdes në përdorimin e tyre.

22.1 Mbledhja e lajmeve nga mediat sociale

Postimet në rrjetet sociale mund të na japin informacione, elementë të lajmeve, por edhe kontributorë të programeve, por është e rëndësishme që ato të trajtohen me shumë kujdes ashtu sikundër çdo burim tjetër.

Pretendimet dhe deklaratat e bëra në rrjetet sociale duhen kontrolluar për saktësi. “Media sociale” nuk mund të përdoret si burim i mirëfilltë: është e rëndësishme të thuhet: “x, y, përmes faqes së tij/saj thonë se...”

Kur përdorim median sociale për të identifikuar kontributorë/të ftuar në programe, duhet të kemi parasysh faktin se shumë njerëz, duke u ndërgjegjësuar për përdorimin gjithnjë e më të shumtë të medias sociale nga autorët e programeve televizive, qëllimisht postojnë materiale në faqet personale, me shpresën se në këtë mënyrë do të ftohen në televizion. Është shumë e rëndësishme të merret vesh identiteti i të ftuarve. Për të qenë të sigurt nëse janë vërtet ata që paraqiten në mediat e veta sociale, kur është e mundur, duhet të flitet me ta personalisht ose përmes telefonit, për të mësuar më shumë rreth identitetit, pozicionit, rolit dhe statusit që kanë. Duhet treguar kujdes i

veçantë në përdorimin e një materiali i cili mund të jetë bërë publik nga ndonjë anëtar i një organizate që ka interes për lajmin, ose nga një njeri i pa interesuar.

Fotot dhe videot duhen përdorur me kujdes si përsa i përket origjinalitetit, ashtu edhe për çështjet e së drejtës së autorit.

Duhet të jemi të sigurt për gjithçka që i paraqesim audiencës, dhe duhet të jemi po aq të sigurt se nuk përbën problem ligjor përdorimi i materialeve që paraqesim (e drejta e autorit për fotot dhe videot, si rregull, i përket fotografit/realizuesit dhe jo faqes në të cilën janë publikuar).

Duhet të kemi parasysh se përdorimi i materialeve të marra nga mediat sociale ose nga interneti të gjeneruara nga RTSH, u shton besueshmërinë dhe u rrit ndikimin – për këtë arsye duhet treguar kujdes i veçantë në përdorimin e tyre.

Nuk duhet ta marrim të mirëqenë faktin se materiali i një medieje sociale është i saktë dhe duhet të ndërmarim hapa të arsyeshëm lidhur me mënyrën e përdorimit të këtij materiali. Nëse është e nevojshme duhen bërë verifikime të mëtijshme.

Po ashtu duhet treguar kujdes i veçantë, në përdorimin e medias sociale për të gjetur të ftuar/kontributorë për programin.

Është e rëndësishme që të mos e nxisim audiencën tonë të rrezikojë sigurinë personale, apo të të tjerëve, vetëm për hir të faktit se na intereson mbledhja e informacionit. Ne nuk duhet të nxisim njerëz që të thyejnë ligjin me qëllim që të sigurojmë informacionin nëpërmjet tyre.

Duhet marrë parasysh siguria e të ftuarit/kontributorit. Në disa raste mundet që identifikimi i të ftuarit/kontributorit të çojë në rrezikimin e jetës së tij.

Duhet të tregojmë kujdes të veçantë lidhur me informacionin e bërë publik rreth fëmijëve dhe adoleshentëve, të cilët, në asnjë rast, nuk duhet të vihen në rrezik.

Vendimet që kanë të bëjnë me privatësinë, lidhur me fotot/videot që do të përdoren për transmetim apo *online*, do t'i nënshtrohen të njëjtave parime editoriale që zbatojmë kur përdorim materiale tona.

Ne duhet të jemi të sigurt se publiku është i qartë për faktin se burimi i materialit të transmetuar janë mediat sociale. Pra, audiencia duhet ta dijë se nuk është material i RTSH-së apo mediave të tjera.

22.2 Përdorimi i medias sociale për të komunikuar në emër të RTSH-së

Gazetarët dhe punonjësit e RTSH-së nuk mund të shprehin në rrjetet sociale ide apo opinione që dëmtojnë reputacionin e RTSH-së, apo bien ndesh me politikën editoriale të RTSH-së.

Gazetarët dhe punonjësit e RTSH-së nuk mund të përdorin logo, emblema apo simbole të RTSH-së në postimet e tyre private, në rrjetet sociale.

Rrjetet sociale janë një mundësi e shkëlqyer për të publikuar çfarë ne bëjmë dhe sigurisht edhe për gazetarët dhe prezantuesit që të komunikojnë me audiencën. Por duhen patur parasysh disa rregulla të thjeshta:

- Çdo material që shkruhet apo thuhet *online*, duhet trajtuar sikur të ishte për transmetim në radio apo tv. Nuk duhet thënë/bërë asgjë që, kur të shihet apo dëgjohet nga audiencia, do ta vinte në pozitë të vështirë RTSH-në, apo personin.

- Nuk duhet thënë asgjë që vë në pikëpyetje integritetin e RTSH-së, paanësinë apo profesionalizmin e tij.

- Personat që janë të njohur publikisht si punonjës të RTSH-së duhet ta bëjnë të qartë, në identitetin e tyre *online*, që postimet paraqesin pikëpamjet e tyre vetjake. Pra, në profilet e rrjeteve sociale duhet të theksohet qartë se pikëpamjet e shprehura janë vetjake dhe nuk paraqesin ato të RTSH-së.

Në përdorimin e rrjeteve sociale për të promovuar programet dhe personalitetet duhet treguar i njëjti kujdes sikundër për materialet që përdoren për transmetim.

Kur i drejtojmë pyetje audiencës, ose i kërkojmë të ndërmarrin ndonjë veprim, duhet të jemi shumë të qartë çfarë po kërkojmë, cili është kufiri kohor dhe të bëjmë të qartë nëse materiali do të përdoret vetëm *online* apo edhe për transmetim. Duhet të bëhet e qartë nëse do të kontaktohen kontribuesit në rrjete sociale.

Duhet ta bëjmë të qartë se postimi i linqeve në faqet e mediave/organizatave të tjera nuk do të thotë mbështetje apo aprovim nga RTSH. Nevojitet sqarim i mëtijshëm nëse përdorim një link për shkak të rëndësisë së materialit, dhe debatit që zhvillohet rreth një teme të caktuar. Në këtë rast duhet thënë qartësisht se linku nuk nënkupton aprovim apo mbështetje.

23. NDËRVEPRIMI ME AUDIENCËN, ÇMIMET, PROGRAMET ME KUICE, TALENT SHOW etj.

Ndërveprimi bën të mundur që audienca të angazhohet në mënyra të ndryshme: që nga votimi për dikë që e ka shansin e jetës në garë; pjesëmarrja si shikues/shikuese, dëgjues/dëgjuese apo përdorues *online*; çelja e fondeve për bamirësi; pjesëmarrja në lojërat online; kontributi telefonik në radio/televizion apo pjesëmarrja si garues në gara të ndryshme.

Ndërveprimi ofron zgjedhje dhe mundësi për t'u dëgjuar, për të marrë pjesë dhe për të krijuar përmbajtje. Synimi është t'i ofrojmë mundësi kujtdo në mënyra të ndryshme pa përjashtuar as ata që nuk duan të ndërveprojnë.

Besimi është vlera më e rëndësishme e RTSH-së dhe ne nuk duhet të minojmë besimin e publikut. Ne do të jemi të ndershëm dhe të hapur me audiencën dhe në asnjë rast nuk do të çorientojmë askënd qëllimisht. Kur publiku angazhohet në ndërveprim, ai do të trajtohet me respekt, ndershmëri dhe drejtësi. Të dhënat personale të mbledhura do të trajtohen në përputhje me parimet editoriale dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

23.1 Parimet

Ndërveprimi me audiencën do të bëhet në një mënyrë të drejtë, të ndershme dhe ligjore. Në veçanti:

- fituesit do të jenë realë; nuk do të jenë kurrë të sajuar apo të paracaktuar;
- garat ku ka ndërveprim dhe votat do të trajtohen me integritet dhe kujdes të veçantë;
- garat dhe votimi do të kenë rregulla të qarta që do të bëhen të njohura për publikun;
- çmimet do të përshkruhen qartë dhe do të jenë në përputhje me audiencën e synuar.

Në ofrimin e ndërveprimit me audiencën synohet rritja e cilësisë dhe nga pikëpamja editoriale duhet të ketë pritshmëri realiste për pëlqimin e audiencës.

Gazetarët e RTSH-së duhet të respektojnë privatësinë e kujtdo që ndërvepron me ta dhe do të mbledhin të dhëna personale vetëm me pëlqimin e pjesëmarrësve.

Ndërveprimi me audiencën nuk duhet të synojë të nxjerrë përfitime financiare, me përjashtim të rasteve kur RTSH synon të çelë fonde për bamirësi.

RTSH duhet të ruajë kontrollin editorial kur ndërveprimi ndodh në bashkëpunim me organizata të tjera.

23.2 Votimet

Votimet mund të përdoren për programet argëtuese, për të ngritur fonde për bamirësi, për të bërë publike opinionet në çështje që variojnë nga argëtimi te debatet publike për çështje politike.

Në disa raste, rezultati i votimit mund të paraqesë një mundësi të papërsëritshme për të ardhmen e fituesit, mund të ketë interes për grupe të caktuara ose mund të paraqesë përparësi nga pikëpamje financiare.

Të gjitha votimet që organizohen nga RTSH duhet të jenë të ndershme, transparente, të hapura, ligjore dhe t'u përmbahen parimeve editoriale.

Në veçanti, rezultatet e votimit duhen raportuar me saktësi.

RTSH duhet të tregohet e ndershme me këdo që i nënshtrohet gjykimit me votë nga ana e audiencës, ndaj duhet të pasqyrohet me ndershmëri vota e shikuesve/dëgjuesve apo të pranishmëve në program.

Duhet të merren të gjitha masat për të ruajtur integritetin e votimit dhe rezultatit të tij.

Nuk duhet të çorientohet audienca për synimet e votimit.

Afati i mbylljes së votimit duhet të jetë i qartë për audiencën dhe duhet të ketë kohë të mjaftueshme nga ky çast për të bërë të mundur shpalljen e rezultatit në kohë dhe kjo kohë të jetë e mjaftueshme për të verifikuar procesin.

Duhet të ketë informacion të qartë se kur hapet dhe kur mbyllet votimi.

23.3 Materialet e regjistruara dhe ritransmetimet

Duhet treguar kujdes që audienca të jetë e qartë nëse programi që po shikon është i drejtpërdrejtë apo i regjistruar.

Nëse programi është i regjistruar dhe konstatohet një problem me votimin e kryer para transmetimit, i cili mund të hedhë dyshime mbi rezultatit, programi nuk duhet transmetuar pa bërë ndryshimet e duhura.

Nëse programi është ritransmetim duhet bërë e qartë për audiencën që nuk mund të ndërveprojë. Një gjë e tillë mund të arrihet duke hequr numrat e telefonit të shfaqur në ekran apo duke hequr materialin në pjesën ku i referohet votimit.

23.4 Çmimet

Çmimet duhet të përshkruhen me saktësi.

Çmimet për fëmijët duhet të jenë të përshtatshme për moshën e tyre dhe si rregull duhet të jenë modeste.

RTSH nuk ofron çmime në para për shikuesit, dëgjuesit dhe pjesëmarrësit online. Në rastet kur propozohet një gjë e tillë, vendimi merret në nivelin më të lartë drejtues. Çmime në para nuk duhen ofruar për lojëra apo garat e fëmijëve.

23.5 Shërbimi telefonik

Shërbimi telefonik përdoret për gara, për të mbështetur programet, për telefonata në studio, për votim, për të çelur fonde për bamirësi, për të ndërvepruar në emisione argëtuese etj. Audienca duhet të jetë e qartë për koston e telefonatës në programet e RTSH-së dhe për rastet kur vendosen tarifa të veçanta.

Tarifa të veçanta vendosen në ato raste kur RTSH nuk e përballon vetë, në mënyrë efektive, numrin e madh të telefonatave. Në këto raste duhet vendosur tarifa më e ulët e mundshme. RTSH nuk vendos tarifa telefonike me qëllim fitimi, me përjashtim të rasteve të thirrjeve për bamirësi.

23.6 Lojrat dhe kuicet

23.6.a Përzgjedhja e pjesëmarrësve

Përzgjedhja e pjesëmarrësve nuk duhet të sjellë dëmting të reputacionit të RTSH-së. Kujdes duhet treguar në përzgjedhjen e pjesëmarrësve për të mënjanuar personat që janë qartësisht jo të përshtatshëm, p.sh., persona të dënuar për krime të rënda.

23.6.b Ndershmëria ndaj pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit duhet të trajtohen me ndershmëri, drejtësi dhe respekt. Ata duhet të jenë të qartë për rregullat e lojës dhe si rregull duhet të kenë informacion të hollësishëm se çfarë pritët prej tyre dhe se çfarë mund të ndodhë gjatë lojës. Në rast se do të përshkruhen apo gjenden në situata humori është e rëndësishme që ata të ndihen pjesë e shakasë dhe jo të ndiejnë se po bëhet shaka me ta. Kujdes i posaçëm duhet treguar kur pjesëmarrësit janë rekomanduar nga familjarë apo miq të tyre.

23.6.c Siguria

Shëndeti dhe siguria e garuesve dhe pjesëmarrësve janë parësore për RTSH-në. Garuesve nuk do t'u kërkohet asgjë që vë në rrezik jetën e tyre. Aty ku është e mundur kërkohet mendim i specializuar.

Për të shmangur sjelljet imituese apo akuzat për papërgjegjshmëri duhen bërë të qarta për publikun masat e sigurisë që janë ndërmarrë.

23.6.d Rregullat

Duhet të ketë rregulla të qarta se si funksionojnë kuicet apo lojrat, çfarë pritet prej pjesëmarrësve dhe kushtet e pjesëmarrjes në garë.
Pjesëmarrësit duhet të informohen paraprakisht për rregullat dhe duhet t'i miratojnë ato.

24. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Kodi i Etikës, Parimet Editoriale dhe Standardet Profesionale të RTSH-së do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

Ky dokument do të botohet, do të bëhet i qasshëm për publikun në variantin e printuar, në Teletekst dhe në faqen zyrtare të internetit të RTSH-së, si edhe do të shpërndahet për të gjithë punonjësit në formë të shtypur.

Kodi i Etikës, Parimet Editoriale dhe Standardet Profesionale të RTSH-së u miratuan nga Këshilli Drejtues i RTSH-së me Vendimin Nr.72, nr.prot.3813, datë 23/11/2016.